

EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

SEKSIONI I KATËRT I MËPARSHËM

ÇËSHTJA KAÇIU DHE KOTORRI KUNDËR SHQIPËRISË

(Ankimet nr. 33192/07 dhe 33194/07)

VENDIM

STRASBURG

25 Qershor 2013

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në Nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt i mëparshëm), duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

David Thór Björgvinsson, *President,*
Lech Garlicki,
Päivi Hirvelä,
George Nicolaou,
Ledi Bianku,
Nebojša Vučinić,
Vincent A. De Gaetano, *gjykatës,*

dhe Françoise Elens-Passos, *Regjistrues i Seksionit,*

Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 7 Shkurt 2012 dhe 28 Maj 2013,

Shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar në atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në dy ankimet (nr. 33192/07 dhe 33194/07) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas Nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga dy shtetasit Shqiptarë, Z. Olsi Kaçiu ("ankuesi i parë") dhe Z. Elidon Kotorri ("ankuesi i dytë"), më 13 Korrik 2007

2. Ankuesit u përfaqësuan nga Z. H. Kopani, avokat që ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria Shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga Agjentja e atëhershme e saj, Znj. E. Hajro dhe më pas nga Znj. L. Mandia nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Ankuesit bënë shumë ankesa sipas Neneve 3, 5 §§ 1 dhe 3, 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri (d) si dhe 7 të Konventës që rrjedhin nga procedimet penale paraqitur ndaj tyre në lidhje me vrasjen e tre personave.

4. Më 21 Tetor 2009 Presidenti i Seksionit të Katërt vendosi të njoftonte Qeverinë mbi ankimet. Gjithashtu u vendos të shqyrtohej pranueshmëria dhe meritat e ankimeve në të njëjtën kohë (Neni 29 § 1).

5. Më 19 Prill 2011 Presidenti i Seksionit të Katërt vendosi t'i komunikonte Qeverisë një ankim shtesë. Palët iu përgjigjën me shkrim vëzhgimeve të njëra-tjetrës.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesit kanë lindur përkatësisht në vitin 1979 dhe 1975. Ankuesi i parë banon në Tiranë, dhe ankuesi i dytë vuan dënimin me burgim të përjetshëm në Burgun e Sigurisë së Lartë në Peqin (Shqipëri).

A. Historiku i Çështjes

7. Më 11 Janar 2000 tre njerëz u vranë dhe një u plagos rëndë. Raporti i vendit të krimit tregonte se sende të ndryshme, duke përfshirë dy kapuçë dhe dy palë doreza u gjenden në vendin e krimit. Në një prej palëve të dorezave u gjenden fije floku. Në bazë të vendimit të oficerit të policisë gjyqësore, këto sende u dërguan për ekzaminim biologjik për të përcaktuar nëse në to mund të gjendeshin fije floku.

8. Më 22 Janar 2000, raporti biologjik i ekspertit konfirmoi se në kapuçët dhe një prej palëve të dorezave u gjetën 12 fije floku me rrënjë.

9. Prokuroria vendosi të fillojë hetimin penal.

B. Arrestimi i ankuesit të parë

10. Ankuesi i parë ishte punësuar në biznesin e drejtuar nga familja e ankuesit të dytë.

11. Më 18 Prill 2000, pas një kontrolli në apartamentin e tij një ditë më parë, ankuesi i parë u arrestua dhe u akuzua për mbajtje pa leje të municionit të gjetur në apartamentin e tij.

12. Më 19 Prill 2000 ai u mor në pyetje nga prokurori. Procesverbali i nënshkruar nga ankuesi deklaroi se ankuesi i parë zgjodhi të përfaqësohej vetë. Gjatë marrjes në pyetje, ankuesi pohoi se municioni gjendej në apartamentin e tij që nga trazirat civile të vitit 1997. Për sa i përket krimit të datës 11 Janar 2000 ai bëri deklarata vetë-inkriminuese të cilat gjithashtu inkriminonin edhe ankuesin e dytë. Rrjedhimisht, ai u akuzua për moskallëzim të krimit të datës 11 Janar 2000.

13. Sipas ankuesit të parë, ai bëri këto deklarata vetë-inkriminuese si rezultat i dhunës së rëndë të ushtruar ndaj tij nga oficerët e policisë më 19 Prill. Ai pretendoi se nuk ishte lejuar të takonte avokatin mbrojtës të zgjedhur prej tij gjatë dy javëve në vazhdim.

14. Më 20 Prill 2000, ankuesi i parë parashtroi se ai duhej të mbahej nga oficerët e policisë në sallën e dëgjimit për shkak të gjendjes së dobët shëndetësore dhe se ai kishte shenja të dukshme te keqtrajtimit në fytyrë. Në të njëjtën datë, u konfirmua nga Gjykata e Rrethit të Tiranës ("Gjykata e Rrethit") ligjshmëria e arrestimit të tij. Asnjë afat nuk u caktua mbi kohëzgjatjen e ndalimit të tij. Ankuesi i parë u mbrojt nga një avokat mbrojtës i caktuar nga gjykata, megjithëse ai pretendoi se kishte caktuar një avokat mbrojtës të zgjedhur prej tij. Procesverbali tregonte se avokati mbrojtës i caktuar nga gjykata kishte tërhequr vëmendjen e gjykatës mbi shenjat që tregonin se ankuesi ishte rrahur. Procesverbali, në pjesët përkatëse, përcakton:

> "[avokati mbrojtës tha]: Klienti im nuk e pranon akuzën e moskallëzimit të krimit. Ai është rrahur në polici dhe ka shenja" [rrahjeje].

15. Ankuesi i parë apeloi, duke kërkuar ndryshimin e urdhrit të ndalimit të caktuar për të.

16. Më 31 Maj dhe 14 Korrik 2000, përkatësisht Gjykata e Apelit të Tiranës ("Gjykata e Apelit") dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 20 Prill 2000, me argumentin se ndalimi i ankuesit të parë bazohej në dyshimin e arsyeshëm se ai kishte kryer shkeljet në fjalë.

C. Arrestimi i ankuesit të dytë

17. Më 11 Prill 2000 prokurori lëshoi një urdhër arresti sipas Nenit 76 të Kodit Penal ("KP") në lidhje me ankuesin e dytë për dyshimin se ka kryer krimin e datës 11 Janar 2000.

18. Më 18 Prill 2000 u arrestua ankuesi i dytë. Procesverbali i datës 18 Prill 2000 me deklarime të bëra nga ankuesi i dytë si person ndaj të cilit zhvillohen hetime paraqiti një dëshmi të detajuar të aktiviteteve të tij më 11 Janar 2000, data në të cilën janë kryer veprat për të cilat ai dyshohej. Ankuesi dha deklarimet në mungesë të një avokati mbrojtës dhe nënshkroi procesverbalin. Ai gjithashtu bëri deklarime në lidhje me aktivitetet e tij më 23 Dhjetor 1999, datë në të cilën ishte kryer një vrasje tjetër.

19. Më 18 Prill 2000, nga ankuesi u morën disa fije floku dhe u dërguan për ekzaminim biologjik. Ankuesi pretendon se fijet e flokëve janë marrë me forcë.

20. Më 19 Prill 2000 ankuesi u akuzua sipas Nenit 78 të Kodit Penal për disa akuza të vrasjes me paramendim në bashkëpunim me të tjerët, përveç mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit, në lidhje me krimin e datës 11 Janar 2000. Dokumenti shprehte se, mbi bazën e një hetimi paraprak, kishte informacione të mjaftueshme për të konstatuar se ankuesi i dytë kishte kryer veprën penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim me të tjerët sipas Neneve 78 dhe 25 të KP. Ankuesi i dytë u akuzua gjithashtu për mbajtje pa leje të armëve të zjarrit sipas Nenit 278 § 2 të KP.

Në të njëjtën ditë, ankuesi i dytë u pyet nëse dëshironte të përfaqësohej. Ai u përgjigj se do të jepte shpjegime në prani të avokatit mbrojtës të tij, K.S. Ai i nënshkroi të dy dokumentet.

21. Më 19 Prill 2000, prokurori kërkoi vlefshmërinë e arrestimit të ankuesit të dytë. Në të njëjtën ditë, raporti biologjik i ekspertit konfirmoi se flokët e ankuesit të dytë kishin të njëjtat karakteristika morfologjike (makro- dhe mikroskopike) si katër fijet e flokut të gjetura në një nga kapuçët e ekzaminuar më 22 Janar 2000.

22. Më 20 Prill 2000, u konfirmuar ligjshmëria e arrestimit të ankuesit të dytë nga Gjykata e Rrethit, e cila deklaroi se ankuesi i dytë është akuzuar për veprën penale të vrasjes me paramendim të kryer në bashkëpunim me të tjerë sipas Neneve 78 dhe 25 të KP dhe për mbajtje të paligjshme të armëve të zjarrit sipas Nenit 278 § 8 i KP. Asnjë afat nuk u caktua mbi kohëzgjatjen e ndalimit të tij. Ai u përfaqësua nga një avokat mbrojtës i zgjedhur prej tij. Në të njëjtën seancë gjyqësore, avokati mbrojtës i ankuesit të dytë deklaroi se krahu i klientit të tij ishte mavijosur dhe se ai ishte lënë pa ujë dhe ushqim. Ankuesi i dytë deklaroi se disa fije floku ishin marrë nga koka dhe krahu i tij.

23. Më 6 Maj 2000 u morën në mënyrë të ligjshme 6 fije floku nga ankuesi i dytë në praninëeë avokatit mbrojtës të tij, A.R., për testin e ADN-së. Meqenëse teste të tilla nuk mund të kryheshin në Shqipëri për shkak të mungesës së teknologjisë përkatëse, u vendos që ekzaminimi i fijeve të flokut të bëhej në Romë, Itali.

24. Më 23 Tetor 2000 konstatimet e raportit të ADN-së që ishte kryer në Itali konfirmuan se ADN-ja e flokëve të ankuesit të dytë përputhej me atë të një prej fijeve të flokut të gjetura në një nga kapuçët.

25. Më 20 Dhjetor 2000, prokurori shtoi akuzat kundër ankuesit të dytë duke e akuzuar atë për vrasje me paramendim të pesë personave, kryer në vitin 1999, sipas Neneve 78 dhe 25 të KP. Akuza e fundit u rrëzua për mungesë provash.

26. Më 5 Janar 2001 prokurori njoftoi ankuesin e dytë mbi vendimin e tij për të shtuar akuzat kundër tij. Procesverbali i marrjes në pyetje deklaronte se avokati mbrojtës i ankuesit të dytë kërkoi të njihej me provat kundër ankuesit. Atij iu treguan procesverbalet e lartpërmendura të ekspertit të datës 19 Prill dhe 23 Tetor 2000. Ai u njoftua se do të siguroheshin prova të tjera në kohën e duhur, menjëherë pas përfundimit të hetimit.

D. Procedimet penale

27. Më 12 dhe 19 Janar 2001, ankuesit u paraqitën për gjykim: ankuesi i parë me akuzën për moskallëzim të krimit sipas Nenit 300 të Kodit Penal dhe ankuesi i dytë për disa akuza të vrasjes me paramendim dhe vrasjes me paramendim të mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim me të tjerë si dhe për mbajtje pa leje të armëve luftarake, sipas Neneve 78 dhe 25 dhe 278 § 2 i KP. Akuza e mbajtjes pa leje të municionit në lidhje me ankuesin e parë u rrëzua.

28. Në seancat gjyqësore më 26 Mars dhe 4 Tetor 2001, ankuesi i parë konfirmoi se ai i ishte nënshtruar dhunës nga policia gjatë marrjes në pyetje më 19 Prill 2000 dhe, si rezultat, kishte bërë deklarata vetë-inkriminuese duke inkriminuar gjithashtu ankuesin e dytë. Ai gjithashtu deklaroi se i ishte mohuar e drejta e avokatit mbrojtës gjatë dy javëve të para të ndalimit.

Procesverbali i datës 26 Mars 2001, në pjesët përkatëse deklaronte:

> [Avokati mbrojtës i ankuesit të dytë tha]: [ankuesi i parë] është masakruar dhe rrahur nga policia e Durrësit dhe është detyruar të nënshkruante procesverbalet.

Procesverbali i datës 4 Tetor 2001, në pjesët përkatëse, deklaronte:

> "[ankuesi i parë tha]: ato [policia] *më çuan në Durrës duke më rrahur e duke më pyetur për Elidonin [ankuesi i dytë]. Për vrasjen nuk di asgjë. Ata filluan të më rrihnin e më thonë se do të lirojmë, po thuaj se [atë] e ka vrarë Elidon Kotorri. Ato mbushën shumë fletë e më thonin hidh firma. Për vrasjen që ka ndodhur nuk di asgjë*.
>
> *Shpjegimet e para janë marrë me dhunë që s'ka ndodhur asnjëherë. Janë të dokumentuara me shkrim të gjitha. Nuk e pranoj akuzën dhe jam trajtuar keq*.
>
> ...
>
> *Nuk jam dakord me ato që tha prokurori...kam kërkuar dhe ato më rrahën edhe më keq. Kam qenë dy javë pa avokat mbrojtës.*

29. Në parashtrimin e tij të fundit të datës 25 Tetor 2001, ankuesi i parë nuk e pranoi fajin, duke u bazuar në të drejtën e tij për të mos inkriminuar veten.

30. Më 1 Nëntor 2001 Gjykata e Rrethit shpalli fajtor ankuesin e parë për moskallëzim të krimit dhe e dënoi atë me 3 vjet burgim. Ankuesi i dytë u shpall gjithashtu fajtor sipas akuzës dhe u dënua me burgim të përjetshëm.

31. Të dy ankuesit apeluan. Ankuesi i parë u ankua për shkelje të së drejtës së tij për të mos inkriminuar veten si rezultat i deklaratave të nxjerra nën ndikimin e forcës. Ankuesi i dytë u ankua për parregullsi në përgatitjen e procesverbalit të vendit të krimit dhe procesverbaleve të ADN-së. Gjithashtu, ai u ankua se marrja në pyetje e ankuesit të parë më 19 Prill 2000 mbi bazën e deklaratave të së cilës ai ishte shpallur fajtor, kishte qenë në shkelje të Nenit 167 § 4 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP").

32. Më 29 Prill 2002, eksperti N.C, i cili kishte përgatitur raportin e ADN-së, paraqiti prova para gjykatës, për kryerjen e testit të ADN-së të fijeve të flokut të gjetura në kapuçë dhe të atyre të marrë nga ankuesi i dytë. Ankuesit nuk morën pjesë në seancën gjyqësore, por u përfaqësuan nga avokatët e tyre mbrojtës, të cilët e pyetën ekspertin.

33. Më 10 Qershor 2002, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Të dy ankuesit apeluan në Gjykatën e Lartë, duke u bazuar mbi të njëjtat argumente si më parë në Gjykatën e Apelit. Ankuesi i parë u përfaqësua nga avokati mbrojtës N.F. dhe ankuesi i dytë nga avokati mbrojtës G.G.

34. Më 15 Janar 2003, Gjykata e Lartë pushoi të dyja vendimet e gjykatave më të ulëta për shkak të parregullsive në procesin e hetimit penal, sidomos në mbledhjen e kapuçëve dhe dorezave dhe ekzaminimin e flokëve. Në lidhje me këtë, Gjykata e Lartë deklaroi se procesverbali i vendit të krimit nuk kishte të dhëna në lidhje se me çfarë u gjet në kapuçë, ndërkohë që kishte theksuar fijet e flokut të gjetura në një palë doreza. Meqenëse nuk ishte përgatitur asnjë raport i veçantë, kjo gjë ngrinte pyetje për sa i përket lidhjes së vërtetë ndërmjet fijeve të flokut të gjetura në një nga kapuçët dhe fijeve të flokut të marra nga ankuesi dhe të dërguara për ekzaminim biologjik më 6 Maj 2000. Përveç kësaj, dispozita e përcaktuar në Nenin 509 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës, letër porositë drejtuar autoriteteve të huaja duhet të kanalizohen nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, nuk është respektuar. Gjithashtu, gjykatat më të ulëta nuk kishin marrë në konsideratë disa prova të tjera po aq të rëndësishme, të tilla si informacionet e marra nga bisedat telefonike në lidhje me telefonin celular të ankuesit të dytë si dhe analizën e shenjave të gishtave të gjetura në vendin e krimit. Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar shkelje për sa i përket marrjes në pyetje të ankuesit të parë më 19 Prill 2000, përderisa ai kishte vendosur të përfaqësonte veten në atë fazë.

1. Seria e parë e procedurave të rigjykimit

35. Më 28 Maj 2003, gjatë procedurës së rigjykimit, oficeri i policisë A.M., i cili kishte qenë në krye të hetimit të vendit të krimit, dëshmoi para gjykatës. Ai u pyet nga të dy ankuesit në lidhje me mbledhjen e provave materiale në vendin e krimit, veçanërisht në lidhje me procedurën për mbledhjen e fijeve të flokut të gjetura në kapuçë. A.M. deklaroi se, ndërsa fijet e flokut mund të dalloheshin me sy të lirë mbi një palë doreza, gjë që u shënua në procesverbalin e vendit të krimit, kapuçët u morën për ekzaminim biologjik për të përcaktuar praninë e fijeve të flokut në mungesë të fijeve të flokut të dallueshme me sy të lirë.

36. N.C. u ripyet gjithashtu në një datë të pacaktuar siç edhe dy dëshmitarët e tjerë.

37. Më 18 Korrik 2003, Gjykata e Rrethit e shpalli fajtor ankuesin e parë me akuzën për moskallëzim të krimit duke u bazuar në deklaratën e tij të datës 19 Prill 2000. Ai u dënua me dy vjet burgim. Ankuesi i dytë u shpall fajtor për tre akuza të vrasjes sipas Neneve 78 dhe 25 të KP. Dënimi i tij u bazua në pohimin e fajit nga ankuesi i parë, raportet e ADN-së në lidhje me fijet e flokut, dhe raporte të tjera të hetimit penal. Ai u dënua me burgim të përjetshëm.

38. Të dy ankuesit apeluan. Ato argumentuan se Gjykata e Rrethit nuk kishte vepruar në përputhje të plotë me udhëzimet e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 Janar 2003 në lidhje me ligjshmërinë e mbledhjes së provave materiale dhe vlerësimin e tyre. Ato gjithashtu u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre për të mos inkriminuar veten nën ndikimin e forcës.

39. Më 30 Shtator 2003, Gjykata e Apelit pushoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe e ktheu çështjen për rigjykim, duke konstatuar se Gjykata e Rrethit nuk kishte respektuar masat procedurale që duhet të ishin marrë në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 15 Janar 2003. Ajo theksoi, *inter alia*, se gjykatat më të ulëta nuk kishin shqyrtuar ligjshmërinë e administrimit të provave materiale. Prokurori apeloi.

40. Më 10 Dhjetor 2003, Gjykata e Lartë pushoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ia ktheu çështjen për rigjykim të njëjtës gjykatë. Ajo konstatoi se Gjykata e Rrethit kishte vepruar pjesërisht në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 15 Janar 2003. Për shembull, ajo kishte thirrur dhe pyetur oficerin e policisë A.M dhe ekspertin N.C., të cilët kishin dhënë shpjegime të hollësishme për sa i përket procedurës për mbledhjen e provave, identifikimin e fijeve të flokut dhe kryerjen e ekzaminimit biologjik. Dëshmitë e tyre mundësuan Gjykatën të bënte vlerësimin e duhur të vërtetësisë së provave pas paraqitjes së

tyre për shqyrtim gjyqësor së bashku me provat e tjera. Megjithatë, Gjykata e Rrethit nuk kishte marrë të dhënat e bisedave telefonike në lidhje me telefonin celular të ankuesit të dytë. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë vendosi se Gjykata e Apelit duhet të kishte gjykuar çështjen mbi pikat e faktit dhe të së drejtës në përputhje me Nenin 427 të KPP-së. Nga pesë gjyqtarët të cilët vendosën apelimin, dy gjyqtarë (K.N dhe S.S) kishin qenë anëtarë të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë më 15 Janar 2003.

2. Seria e dytë e procedurave penale

41. Më 23 Shtator 2004, Kryetari i Gjykatës së Apelit i kërkoi Këshillit të Lartë të Drejtësisë, organit përgjegjës për thirrjen, transferimin dhe promovimin e gjyqtarëve, si dhe përfundimin e shërbimit të tyre për të emëruar tre gjyqtarë që të dëgjojnë çështjen kundër ankuesve. Sipas shkresës së tij, të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit kishin qenë më parë pjesëtarë të trupit gjykues që kishin dëgjuar çështjen kundër ankuesve.

42. Më 15 Tetor 2004, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendosi, sipas nenit 28 të Aktit të Sistemit Gjyqësor, të transferojë tre gjyqtarët e Gjykatës Ushtarake të Apelit në Gjykatën e Apelit për të dëgjuar çështjen e ankuesve.

43. Në seancën gjyqësore të datës 2 Dhjetor 2004 para Gjykatës së Apelit, ankuesi i dytë, i cili u përfaqësua nga avokati mbrojtës S.G., kërkoi paraqitjen e tre dëshmitarëve N.C., A.M., dhe A.V. Gjykata e Apelit vërejti se dy nga këta dëshmitarë, N.C dhe A.M kishin dëshmuar para gjykatave. Ajo e konsideroi të panevojshme thirrjen e dëshmitarit të tretë, A.V., meqenëse dokumentet që gjendeshin në dosjen e çështjes ishin të mjaftueshme për të proceduar dhe për të vendosur mbi çështjen. Avokati mbrojtës argumentoi se provat materiale, domethënë grumbullimi i fijeve të flokut dhe raportet e ADN-së, nuk ishin kryer në përputhje me ligjin dhe nuk kishte pasur asnjë analizë të shenjave të gishtërinjve. Avokatit mbrojtës i është dhënë një orë kohë më shumë, sipas kërkesës, për fjalën e tij përfundimtare.

44. Në parashtrimet e tij përfundimtare, avokati mbrojtës i ankuesit të dytë argumentoi se ankuesi i parë kishte bërë deklarata inkriminuese si pasojë e rrahjes. Avokati mbrojtës kërkoi kohë shtesë prej katër ditësh me qëllim që të kishte akses në të dhënat e bisedave telefonike dhe të sillte në vëmendje të gjykatës faktet në lidhje me karakterin e pretenduar të turpshëm të një prej viktimave. Gjykata e informoi atë se ajo i kishte trajtuar tashmë këto kërkesa në një vendim të përkohshëm në një seancë gjyqësore të mëparshme. Për sa i përket të dhënave të bisedave telefonike, mbi bazën e një shkrese të ofruesit të shërbimit telefonik, gjykata vendosi se ishte e pamundur marrja e të dhënave të tilla.

45. Përfaqësuesi i ankuesit të parë nuk ishte i pranishëm në të njëjtën seancë gjyqësore. Sipas procesverbalit, ankuesi i parë deklaroi se nuk do të shprehte asgjë dhe se ai ishte dakord me mbrojtjen e avokatit të tij.

46. Në të njëjtën ditë, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 18 Korrik 2003. Ajo konstatoi se të gjitha provat, përkatësisht raportet e ADN-së, deklarata inkriminuese e ankuesit të parë dhe prova të tjera mjeko-ligjore, ishin marrë në mënyrë të ligjshme në përputhje me KPP dhe vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 15 Janar 2003. Gjykata, duke u bazuar në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 10 Dhjetor 2003 (shih paragrafin 40 më lart), deklaroi se rezultatet e testeve të ADN-së konfirmuan se fijet e flokut i përkisnin ankuesit të dytë. Përfundimisht, Gjykata vendosi që ankuesi i dytë të vuajë dënimin e tij në një burg të sigurisë së lartë. Ekstraktet përkatëse të vendimit të Gjykatës së Apelit përcaktojnë si më poshtë:

> "Për sa i përket argumenteve të pandehurit në lidhje me shtrirjen e hetimit duke marrë në pyetje dëshmitarë të tjerë dhe prova shtesë, trupi gjykues vlerëson se, në rigjykimin e çështjes, Gjykata mori

parasysh dhe arriti në përfundimin se provat materiale janë marrë në përputhje të plotë me kërkesat e KPP-së dhe, rrjedhimisht, të gjitha çështjet janë zgjidhur ligjërisht. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe gjatë ridëgjimit, Gjykata kreu veprime të nevojshme të cilat në mënyrë të bindshme dhe të plotë konfirmuan vërtetësinë e vlerës provuese të ekzaminimit biologjik të fijeve të flokut, të cilat ishin konfirmuar se i përkasin Elidon Kotorrit [ankuesi i dytë].

...

Veprimet procedurale të kryera gjatë hetimit ishin në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu kjo vlen edhe për përdorimin e provave materiale dhe, mbi këtë bazë, vendimi i gjykatës më të ulët është i bazuar dhe i drejtë. Grumbullimi i fijeve të flokut ishte në përputhje me kërkesat procedurale dhe urdhrat e autoritetit përgjegjës dhe u ekzaminua në laborator. Gjykata, në mënyrë korrekte konstaton se këto prova janë të ligjshme, në lidhje me prova të tjera, sepse... u administruan në përputhje me kërkesat e Nenit 508 të KPP-së.

Në shqyrtimin e çështjes, rezulton se nuk ka pasur shkelje të dispozitave kushtetuese të së drejtës së të pandehurit (Elidon Kotorrit). Gjykimi ka qene i drejtë, i barabartë dhe i ligjshëm. Rezulton se dispozitat procedurale në lidhje me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin janë zbatuar siç duhet...”

47. Ankuesit apeluan.

48. Më 16 Shtator 2005, Gjykata e Lartë deklaroi apelimin e tyre të papranueshëm meqenëse argumentet e tyre binin jashtë objektit të Nenit 432 të KPP-së. Nga pesë gjyqtarët të cilët vendosën për çështjen më 16 Shtator 2005, tre gjyqtarë (K.N., S.S., dhe Y.M.) kishin qene anëtarë të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë më 10 Dhjetor 2003. Gjyqtarët K.N. dhe S.S. kishin dëgjuar gjithashtu apelimet e ankuesve më 15 Janar 2003.

49. Të dy ankuesit apeluan para Gjykatës Kushtetuese. Ankuesi i parë argumentoi se ishte shkelur e drejta e tij për të mos inkriminuar veten. Ai ishte detyruar të bënte deklarata vetë-inkriminuese në mungesë të avokatit mbrojtës. Ai kishte tërhequr pranimin e fajit nga ana e tij, por megjithatë ishte dënuar pa prova të tjera bindëse të paraqitura kundër tij. Ai gjithashtu u ankua se në seancën gjyqësore të datës 2 Dhjetor 2004, Gjykata e Apelit nuk i kishte caktuar atij avokat të caktuar nga gjykata. Ankuesi i dytë u ankua se procedurat gjyqësore kishin qenë të padrejta meqenëse ishin pranuar deklaratat e pohimeve të ankuesit të parë dhe prova të tjera të marra në mënyrë të paligjshme, përkatësisht provat e fijeve të flokut dhe kryerjen e testeve të ADN-së. Ai pretendoi se nuk ishte njoftuar menjëherë për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij kur ai ishte arrestuar meqenëse akuza ishte ri-cilësuar nga vrasje sipas Nenit 76 në vrasje me paramendim sipas Nenit 78 të KP-së. Ai deklaroi se nuk kishte pasur mundësi të pyeste disa dëshmitarë. Ai gjithashtu argumentoi se Gjykata e Apelit e cila u mblodh më 2 Dhjetor 2004 nuk ishte një "gjykatë e krijuar me ligj", duke pasur parasysh se në të ishin transferuar tre gjyqtarë nga Gjykata Ushtarake e Apelit.

50. Më 6 Shkurt 2007 Gjykata Kushtetuese e përbërë prej tre gjyqtarësh i deklaroi ankimet të papranueshme. Ajo arsyetoi se ankimet e ankuesve nuk kanë ngritur asnjë çështje të gjykimit të drejtë, por lidheshin kryesisht me vlerësimin e provave, gjë që është kompetencë e gjykatave më të ulëta.

E. Kohëzgjatja e paraburgimit të ankuesit të dytë

51. Në një datë të pacaktuar në vitin 2003, ankuesi i dytë kërkoi lirimin e tij meqenëse kishin skaduar afatet e paraburgimit.

52. Më 31 Korrik 2003, Gjykata e Rrethit deklaroi se nuk kishte kompetenca meqenëse meritat e çështjes së ankuesit të dytë ishin vendosur sipas vendimit të saj të datës 18 Korrik 2003. Ajo ia kaloi çështjen Gjykatës së Apelit. Ankuesi i dytë apeloi.

53. Më 17 Shkurt 2004, Gjykata e Apelit deklaroi se nuk kishte juridiksion dhe e kaloi çështjen në Gjykatën Penale të Apelit në Tiranë ("Gjykata Penale e Apelit") në përputhje me Ligjin e Gjykatave Penale (*Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda*). Ankuesi i dytë apeloi.

54. Më 21 Prill 2004 Gjykata e Lartë pushoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ia ktheu çështjen të njëjtës gjykatë. Ajo konstatoi se çështja nuk binte në juridiksionin e Gjykatave Penale dhe se Gjykata e Apelit ishte kompetente për të shqyrtuar kërkesën e ankuesit të dytë.

55. Më 28 Qershor 2004 Gjykata e Apelit vendosi të shqyrtojë kërkesën në të njëjtën kohë me meritat e çështjes penale. Ankuesi i dytë apeloi.

56. Më 27 Korrik Gjykata e Lartë konstatoi se vendimi i Gjykatës së Apelit ishte në kundërshtim me ligjin dhe e pushoi atë.

57. Më 6 Shtator 2004 Gjykata e Apelit rrëzoi kërkesën e ankuesit të dytë dhe konstatoi se nuk ka pasur shkelje të afateve të zbatueshme. Ankuesi i dytë apeloi.

58. Më 8 Nëntor 2004 Gjykata e Lartë pushoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe konstatoi shkelje në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit të ankuesit. Ajo e liroi ankuesin e dytë nga paraburgimi dhe e vendosi atë në arrest shtëpie.

F. Pasqyrimi mediatik i gjykimit të ankuesit të dytë

54. Sipas ankuesit të dytë media ndërtoi një fushatë të ashpër kundër tij. Ajo krijoi artikuj të shumtë shtypi në mbështetje të parashtrimeve të tij.

55. Dy artikuj të muajit Prill 2000 raportuan mbi arrestimin e ankuesit të dytë. Një tjetër artikull i muajit Prill 2004 pasqyroi kohëzgjatjen e paraburgimit të ankuesit të dytë.

56. Lirimi i ankuesit të dytë nga paraburgimi është përshkruar në gjashtë gazeta në Nëntor 2004, me hollësi të barrës financiare të Shtetit për mbajtjen e ankuesit të dytë në arrest shtëpie.

57. Detaje të dënimit të ankuesit të dytë dhe dënimit me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Apelit më 2 Dhjetor 2004 u raportuan nga gjashtë gazeta në muajin Dhjetor 2004.

58. Dy artikuj në muajin Prill 2005 e përshkruan shkarkimin e gjyqtarit D.B nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Sipas artikujve, gjyqtari D.B kishte qenë anëtar i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit, i cili më 30 Shtator 2003, kishte vendosur t'ia kalonte çështjen Gjykatës së Rrethit. Ky vendim, i cili, sipas gazetave, kishte ndikuar në shkarkimin e tij, kishte kontribuar në kohëzgjatjen e paraburgimit të ankuesit të dytë.

G. Vendimi i Gjykatës Penale të Apelit në një tjetër set procedimesh gjyqësore

59. Në një seri më vete procedimesh gjyqësore, në vendimin e saj Nr. 33 të datës 10 Maj 2006, Gjykata Penale e Apelit e liroi të pandehurin A.L nga akuza e vrasjes me paramendim në lidhje me krimin e datës 11 Janar 2000 (shih paragrafin 7 më lart) për mungesë provash. Dënimi i të pandehurit nga gjykata penale e rrethit ishte bazuar në deklaratën e ankuesit të parë të datës 19 Prill 2000 bërë gjatë procedimeve gjyqësore kundër ankuesit të parë (shih paragrafin 12 më lart) dhe mbi raportin e ekspertit për gjurmët e gishtërinjve.

60. Gjykata Penale e Apelit vendosi se deklarata e ankuesit të parë, bërë gjatë një serie tjetër procedimesh gjyqësore kundër tij, nuk përbënte prova për qëllimet e procedimeve gjyqësore kundër A.L. në kuptim të Nenit 193 § 1 të KPP (shih paragrafin 70 më poshtë), që do të shqyrtohej dhe përdorej në lidhje me provat e tjera. Megjithatë, ajo nuk vendosi në lidhje me faktin nëse deklarata e ankuesit të parë ishte marrë në mënyrë të paligjshme.

II. E DREJTA PËRKATËSE E BRENDSHME DHE NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

A. Dispozitat e së drejtës së brendshme

1. Kushtetuta e Shqipërisë

61. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë janë përshkruar në vendimin e Gjykatës në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë,* nr. 26866/05, § 28, 10 Maj 2011.

2. Kodi i procedurës penale

62. Neni 36 parashikon se deklaratat e bëra nga i akuzuari gjatë periudhës së paraburgimit nuk mund të përdoren si prova. Sipas Nenit 39, gjatë marrjes në pyetje në periudhën e paraburgimit, i akuzuari informohet mbi akuzën kundër tij dhe provat mbështetëse. I akuzuari ftohet për të dhënë shpjegimet e tij në favor të mbrojtjes së tij dhe më pas merret në pyetje. Nëse i akuzuari refuzon të përgjigjet, kjo shënohet në procesverbal.

63. Neni 48 përcakton se i akuzuari ka të drejtë të zgjedhë dy avokatë mbrojtës. Sipas Nenit 50, avokati mbrojtës ka të drejtë, *inter alia*, të komunikojë lirshëm dhe privatisht me të akuzuarin, të njoftohet paraprakisht mbi kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore ku i akuzuari është i pranishëm dhe të marrë pjesë në to. Sipas Nenit 53 § 2 i akuzuari i cili është në paraburgim ka të drejtë të komunikojë me avokatin e tij menjëherë pasi është zbatuar masa e sigurisë.

64. Neni 167 § 1 parashikon për personat që ndiqen më vete por që konsiderohen të pandehur në procedime penale të përbashkëta, të merren në pyetje me kërkesën e palës tjetër apo me të drejtë. Neni 167 § 3 parashikon për personat e përmendur në Nenin 167 § 1 që të mbrohen nga një avokat mbrojtës i zgjedhur prej tyre dhe, në mungesë të tij, nga një avokat i caktuar nga Gjykata. Sipas Nenit 167 § 4 para fillimit të marrjes në pyetje, Gjykata duhet të informojë personat e përmendur në paragrafin 1 mbi të drejtën e tyre për të mos folur.

65. Neni 193 § 1 lejon pranimin e transkripteve të një grupi tjetër procedimesh gjyqësore në masën që transkriptet lidhen me provat e marra para gjykatës në fazën e hetimit paraprak ose me provat që pranohen në gjykim.

66. Kodi i Procedurës Penale përcakton se një hetim penal mund të fillohet nga një hetues (policia gjyqësore) ose një prokuror me zgjedhjen e tyre, mbi një ankesë të bërë nga një individ ose duke marrë informacione për veprën e kryer nga burime të tjera (Nenet 277 dhe 280-283). Autorizimi për të proceduar duhet të merret në përputhje me Nenin 288 nga Gjykata e Rrethit. Në mungesë të autorizimit, nuk lejohet asnjë masë tjetër procedurale (Neni 289). Pas marrjes së autorizimit, prokurori vendos për të filluar procedimin penal në qoftë se ekzistojnë arsye për të besuar se është kryer një krim, ose për të refuzuar fillimin e procedimit penal sipas Nenit 290. Ankuesit duhet t'i dërgohet një vendim i arsyetuar që shpjegon refuzimin për të filluar procedimin penal. Refuzimi për të filluar procedimin penal mund të apelohet në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm (Neni 291).

67. Neni 425 përcakton objektin e shqyrtimit të apelimit nga Gjykata e Apelit. Ky Nen parashikon se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Apelit nuk kufizohet vetëm me shkaqet e apelimit por shtrihet në të gjithë çështjen. Sipas Nenit 427, me kërkesën e palës, Gjykata e Apelit është e autorizuar të rishqyrtojë provat e mëparshme dhe materiale të reja shtesë nëse ajo e konsideron të nevojshme. Neni 428 përshkruan llojin e vendimeve që Gjykata e Apelit mund të marrë: ajo mund të vendosë pushimin e apelimit dhe lënien në fuqi të vendimit, ndryshimin e vendimit, pushimin e vendimit dhe nuk lejon fillimin e procedimit, ose pushimin e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

68. Apelimet kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit mund të depozitohen në Gjykatën e Lartë në secilën nga rrethanat e mëposhtme të parashikuara në Nenin 432: a) e drejta penale nuk është respektuar ose është zbatuar në mënyrë të gabuar; b) ka pasur shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimit të Gjykatës në përputhje me Nenin 128 të këtij Kodi; c) ka pasur shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Neni 434 parashikon se Gjykata e Lartë shqyrton apelimin brenda kufijve të shkaqeve të ngritura.

69. Sipas Nenit 509, letër porositë e gjykatave të brendshme drejtuar një autoriteti të huaj, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila është përgjegjëse për t'i nisur ato. Në rastet e ngutshme, autoriteti vendas përgjegjës mund të nisë letër porosinë direkt duke informuar Ministrinë e Drejtësisë.

3. Sistemi Gjyqësor (Organizimi) Akti (Ligji nr. 8436 datë 28 Dhjetor 1998 – Ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë)

70. Seksioni 8 parashikon se gjykatat ushtarake funksionojnë dhe organizohen brenda sistemit gjyqësor në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara me ligj. Seksioni 9 shton se gjykatat ushtarake përbëhen nga gjykatat ushtarake të shkallës së parë dhe gjykatat ushtarake të apelit. Gjykata Ushtarake e Apelit shqyrton apelimet kundër Gjykatës Ushtarake të Shkallës së Parë. Ajo përbëhet nga një panel prej tre gjyqtarësh.

71. Gjyqtarët, pavarësisht nëse ata shërbejnë në gjykatat e shkallës së parë ose gjykatat ushtarake ose civile të apelit, janë të detyruar t'i nënshtrohen formimit të njëjtë arsimor dhe profesional. Emërimi i tyre, i cili nuk ka afat (seksioni 25), kryhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (seksioni 22). Ata janë të pavarur në ushtrimin e detyrave të tyre. Ata mund të largohen nga detyra në rrethana të përcaktuara në mënyrë strikte, përkatësisht kur: (i) japin dorëheqjen; (ii) arrijnë moshën e pensionit; (iii) janë dënuar për një krim me anë të një vendimi të formës së prerë; (iv) janë fizikisht ose mendërisht të paaftë për kryerjen e detyrave të tyre; (v) janë marrë masa disiplinore kundër tyre; (vi) dhe, veprimet ose funksionet e tyre janë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në seksionet 29 deri 35 të Aktit (seksioni 27).

72. Seksioni 28 përcakton se "në qoftë se një gjykatë nuk funksionon normalisht për shkak të mungesës së përkohshme të gjyqtarëve ose çështjeve të grumbulluara, Këshilli i Lartë I Drejtësisë, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë i transferon gjyqtarët nga një gjykatë në një tjetër për një periudhë prej jo më pak se tre muajsh në vit, madje edhe pa pëlqimin e gjyqtarëve. Në mbarim të periudhës së caktuar, Gjyqtari kthehet në punën e tij të mëparshme. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë mund të emërojë një gjyqtar për të dëgjuar çështjet në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel nëse ekziston mungesë gjyqtarësh në këtë Gjykatë."

B. Dispozitat e të drejtës ndërkombëtare publike

73. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Degradues të Dënimit, e cila është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 Dhjetor 1984 (Rezoluta 39/46) dhe e cila ka hyrë në fuqi më 26 Qershor 1987, në pjesët përkatëse që lidhen me këtë çështje parashikon:

Neni 1

"1. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi Torturë nënkupton çdo veprim nëpërmjet të cilit është shkaktuar qëllimisht dhimbje e rëndë ose vuajtje fizike ose mendore mbi një person për qëllime të tilla siç është marrja prej tij ose prej një personi të tretë e informacioneve ose e një pohimi, duke e dënuar atë për një veprim që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet se ka kryer, ose duke e frikësuar apo shtrënguar

atë ose një person të tretë, apo për çdo arsye tjetër të bazuar në diskriminimin e çfarëdo lloji, kur dhimbje ose vuajtje të tilla janë shkaktuar ose nxitur me pëlqimin ose pranimin e një zyrtari publik apo personi tjetër që vepron në një cilësi zyrtare. Ky term nuk përfshin dhimbje ose vuajtje që lindin vetëm nga sanksione të ligjshme, të qenësishme apo të rastësishme.

Neni 15

"Çdo Palë Shtetërorë duhet të garantojë se çdo deklaratë që është siguruar si pasojë e torturës nuk duhet të pranohet si provë në asnjë procedim gjyqësor, me përjashtim të rastit kundër një personi që akuzohet për torturë si provë që vërteton marrjen e deklaratës."

Neni 16

"1. Çdo Palë Shtetërore duhet të ndërmarrë parandalimin në çdo territor të juridiksionit të saj të veprimeve të tjera të trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues apo ndëshkimit të cilat nuk përbëjnë torturë siç përcaktohet në Nenin 1, kur veprime të tilla kryhen ose nxiten me pëlqimin ose pranimin e një zyrtari publik apo personi tjetër që vepron në cilësinë zyrtare. Në veçanti, detyrimet e përfshira në Nenet 10, 11, 12 dhe 13 do të zbatohen me zëvendësimin për referencat ndaj torturës me referencat ndaj formave të tjera të trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues apo dënimit."

74. Konventa hyri në fuqi në lidhje me Shqipërinë më 11 Maj 1994.

E DREJTA

I. BASHKIMI I ANKIMEVE

75. Duke pasur parasysh se dy ankimet lidhen me të njëjtat fakte dhe procedime të gjykatave të brendshme, Gjykata vendos se ato duhet të bashkohen sipas rregullit 42 § 1 e Rregullores së Gjykatës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 3 TË KONVENTËS

76. Ankuesi i parë u ankua sipas Nenit 3 se ai ishte keqtrajtuar nga oficerët e policisë gjatë paraburgimit të tij dhe se nuk kishte pasur hetim efektiv lidhur me pretendimet e tij. Neni 3 i Konventës parashikon si më poshtë:

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese."

A. Pranueshmëria

77. Qeveria argumentoi se ankuesi i parë nuk kishte ezauruar mjetet ligjore të brendshme sepse nuk u ankua formalisht para prokurorit dhe se ankimi ishte depozituar më shumë se gjashtë muaj pas keqtrajtimit të pretenduar. Ankuesi i parë argumentoi se kishte frikë të ankohej tek prokurori nga frika se mund të keqtrajtohej përsëri.

78. Gjykata vlerëson se kundërshtimet e Qeverisë lidhen me meritat e ankimit të ankuesit të parë dhe rrjedhimisht vendos t'i bashkojë ato me meritat.

79. Meqenëse ky ankim nuk është i papranueshëm për asnjë arsye tjetër, rrjedhimisht duhet të deklarohet i pranueshëm.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

80. Ankuesi i parë pretendoi se më 19 Prill 2000, ai është rrahur nga oficerët e policisë. Meqenëse ai nuk ishte në gjendje të ecte apo të qëndronte në këmbë më 20 Prill 2000, ai duhej të mbahej nga oficerët e policisë në seancën e tij të parë. Publiku nuk u lejua të merrte pjesë në seancë. Avokati i tij mbrojtës i caktuar nga Gjykata parashtroi në seancë se ai ishte rrahur me qëllim që të nxirrnin prej tij pranimin e fajit dhe se ai kishte shenja të dukshme rrahjeje. Megjithatë, autoritetet nuk morën asnjë masë.

81. Qeveria parashtroi se ankuesi i parë nuk kishte paraqitur asnjë detaj për keqtrajtimin e pretenduar. Ai nuk kishte kërkuar asnjëherë të takohej me një mjek. Përfaqësuesi i tij nuk ka bërë kërkesë të tillë me shkrim. Gabimet gramatikore në tekstin e procesverbalit të datës 19 Prill 2000, të cilin ai e kishte nënshkruar, ishin për shkak të nivelit të tij të ulët të arsimimit, dhe jo rezultat i keqtrajtimit. Ankuesi nuk ngriti asnjë pretendim keqtrajtimi në apelimet e tij për ligjshmërinë e arrestimit të tij.

2. Vlerësimi i Gjykatës

(a) Parime të përgjithshme

82. Neni 3 parashikon një prej vlerave themelore të qeverisë demokratike. Edhe në rrethanat më të vështira, të tilla si lufta kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, Konventa ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimin çnjerëzor ose degradues të dënimit, pavarësisht nga sjellja e viktimës. Neni 3 nuk bën asnjë parashikim për përjashtime dhe nuk është i lejueshëm asnjë derogim i tij sipas Nenit 15 § 2 edhe në rastin e një emergjence publike që kërcënon jetën e vendit (*shih Labit kundër Italisë* [GC], nr. 26772/95, § 119, ECHR 2000-IV, dhe *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 15 Nëntor 1996, § 79, *Raporte të Gjykimeve dhe Vendimeve* 1996-V).

83. Me qëllim që keqtrajtimi të bie brenda objektit të Nenit 3, ai duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie. Vlerësimi i këtij niveli varet nga të gjitha rrethanat e çështjes të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike, ose mendore dhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (*shih Ireland kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 18 Janar 1978, § 162, Seria A nr. 25, dhe *Jalloh kundër Gjermanisë* [GC], nr. 54810/00, § 67, ECHR 2006-IX).

84. Gjykata ka vlerësuar trajtimin si çnjerëzor sepse, *inter alia,* ishte i paramenduar, është aplikuar për orë pa ndërprerje dhe ka shkaktuar ose dëmtime të dukshme trupore ose vuajtje të mëdha fizike dhe mendore. Trajtimi është pranuar si degradues kur ishte i tillë që shkaktonte tek viktimat ndjenjën e frikës, ankthit dhe inferioritetit që mund të shkaktonte poshtërimin dhe përuljen e tyre dhe mundësisht thyerjen e qëndrueshmërisë së tyre fizike ose morale, ose kur ishte i tillë që e nxiste viktimën të vepronte kundër vullnetit ose vetëdijes së tij (shih, ndërmjet të tjerash, *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, § 110, ECHR 2001-III; *Labita*, cituar më lart, § 120; *Ramirez Sanchez kundër Francës* [GC], nr. 59450/00, § 118, ECHR 2006‑IX; dhe, *Jalloh*, cituar më lart, § 68).

85. Në përcaktimin nëse një formë e veçantë e keqtrajtimit duhet të konsiderohet si torturë, duhet marrë në konsideratë dallimi, parashikuar në Nenin 3, ndërmjet këtij nocioni dhe atij të trajtimit çnjerëzor ose degradues. Siç Gjykata ka konstatuar paraprakisht, duket se ishte synimi që Konventa duhet, nëpërmjet një dallimi të tillë t'i bashkëngjisë një vulë të veçantë trajtimit të qëllimshëm çnjerëzor që shkakton vuajtje shumë të rënda dhe mizore (shih

vendimi i *Irlandës kundër the Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, § 167; *Aksoy kundër Turqisë*, 18 Dhjetor 1996, § 63, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-VI dhe *Selmouni kundër Francës* [GC], nr. 25803/94, § 96, ECHR 1999-V). Përveç ashpërsisë së trajtimit ekziston një element i qëllimshëm i torturës, i njohur gjithashtu në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Degradues ose Dënimit, i cili në Nenin 1 e përcakton torturën në aspektin e shkaktimit të qëllimshëm të dhimbjes ose vuajtjes së rëndë për qëllime të tilla si marrja e informacionit ose pohimit, dënimi, frikësimi, shtrëngimi, ose për çdo arsye të bazuar në diskriminimin e çfarëdo lloji, kur dhimbje ose vuajtje e tillë shkaktohet nga ose me nxitjen apo pëlqimin ose pranimin e një zyrtari publik apo personi tjetër që vepron në cilësinë zyrtare (shih *Dikme kundër Turqisë*, nr. 20869/92, § 94, ECHR 2000-VIII; *Mikheyev kundër Rusisë*, nr. 77617/01, § 149, 26 Janar 2006; dhe, *Savitskyy kundër Ukrainës*, nr. 38773/05, § 127, 26 Korrik 2012).

86. Pretendimet për keqtrajtim duhet të mbështeten me prova përkatëse. Në vlerësimin e provave të keqtrajtimit, Gjykata në përgjithësi ka pranuar standardin e provës "përtej dyshimit të arsyeshëm." Prova të tilla mund të rezultojnë nga bashkekzistenca e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe përkuese ose nga supozime të ngjashme të pakundërshtueshme të faktit (*Gök dhe Güler kundër Turqisë*, nr. 74307/01, § 33, 28 Korrik 2009).

87. Kur ngjarjet në çështje shtrihen tërësisht ose në pjesën më të madhe në dijeninë ekskluzive të autoriteteve, si në rastin e personave brenda kontrollit të tyre në paraburgim, do të lindin supozime të forta të faktit në lidhje me dëmtimet e shkaktuara gjatë paraburgimit. Në të vërtetë, barra e provës mund të konsiderohet se i përket autoriteteve për të siguruar një shpjegim të kënaqshëm dhe bindës (shih *Salman kundër Turqisë* [GC], nr. 21986/93, § 100, ECHR 2000-VII). Në veçanti, kur një individ, pasi merret në paraburgim, gëzon shëndet të mirë, por konstatohet se është dëmtuar në kohën e lirimit, çdo dëmtim i tillë do të çojë në një supozim të fortë se personi i është nënshtruar keqtrajtimit (shih *Bursuc kundër Romanisë*, nr. 42066/98, § 80, 12 Tetor 2004). Është detyrë e Shtetit të sigurojë një shpjegim të arsyeshëm se si janë shkaktuar dëmtimet, dështimi i të cilit lind një çështje të qartë sipas Nenit 3 të Konventës (shih *Selmouni*, cituar më lart, § 87).

88. Për më tepër, kur një individ bën një pretendim të argumentueshëm se ai ka vuajtur trajtimin në shkelje të Nenit 3 në duart e Policisë apo agjentëve të tjerë të Shtetit, kjo dispozitë parashikon në lidhje me detyrimin e përgjithshëm të Shtetit sipas Nenit 1 të Konventës "Garantimin e secilit brenda juridiksionit mbi të drejtat dhe liritë e përcaktuara në ... Konventë", kërkon sipas nënkuptimit se duhet të ketë një hetim zyrtar efektiv. Një hetim i tillë duhet të ketë aftësinë të çojë në krijimin e fakteve të çështjes dhe, në qoftë se akuzat vërtetojnë se është e vërtetë, në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, *Labita*, cituar më lart, § 131; *Boicenco kundër Moldavisë*, nr. 41088/05, § 120, 11 Korrik 2006; dhe *Lopata kundër Rusisë*, nr. 72250/01, § 109, 13 Korrik 2010).

(b) Aplikimi i parimeve përkatëse në çështjen në fjalë

89. Ankuesi i parë u mbajt në paraburgim më 19 Prill 2000. Gjatë periudhës së paraburgimit, ai pretendoi se ishte rrahur nga oficerët e policisë gjatë marrjes në pyetje me qëllim që të detyrohej të nënshkruante pranimin e fajit. Ai vazhdimisht i bëri të njëjtat parashtrime autoriteteve gjyqësore, në publik dhe në prani të prokurorit, në paraqitjen e tij të parë më 20 Prill 2000 (kur ai u përfaqësua nga një avokat mbrojtës i caktuar nga gjykata i cili tërhoqi vëmendjen e gjykatës ndaj shenjave të dukshme të ankuesit që ishte rrahur), para

gjykimit më 26 Mars dhe 4 Tetor 2001 dhe gjatë apelimeve të tij të mëvonshme. Më tej ai deklaroi se ai ishte detyruar të mbahej në seancën e parë më ndihmën e oficerëve të policisë.

90. Gjykata vëren se me gjithë mungesën e çfarëdo përshkrimi të plagëve të shkaktuara, ankuesi ngriti më shumë se një "pretendim të argumentuar" para autoriteteve vendase se ai ishte rrahur rëndë gjatë periudhës së qëndrimit të tij në paraburgim. Pretendimi i tij krijoi prezumimin e faktit se ankuesi i ishte nënshtruar keqtrajtimit të parashikuar nga Neni 3 në duart e agjentëve të Shtetit dhe i kërkonte Qeverisë të jepte një shpjegim të arsyeshëm se si mund të ishte shkaktuar rrahja e pretenduar.

91. Qeveria, nga ana e saj, nuk ka paraqitur asnjë shpjegim të arsyeshëm për rrahjen e pretenduar. Për shembull, nuk u argumentua asnjëherë se rrahja ishte rezultat i veprimeve të paligjshme nga ana e bashkëvuajtësve apo se ankuesi i kishte pasur shenjat e rrahjes para arrestimit të tij. As nuk ishte kundërshtuar se ankuesi duhej të mbahej nga oficerët e policisë në sallën e gjyqit për shkak të gjendjes së tij të dobët shëndetësore si rezultat i rrahjeve të rënda që kishte pësuar. Në lidhje më këtë, Gjykata rithekson se ekzaminimet përkatëse mjekësore përbëjnë garanci thelbësore kundër keqtrajtimit (shih *Akkoç kundër Turqisë*, nr. 22947/93 dhe 22948/93, §§ 55 dhe 118, ECHR 2000 – X; *Parnov kundër Moldavisë*, nr. 35208/06, § 30, 13 Korrik 2010) para, gjatë dhe me lirimin nga paraburgimi.

92. Ndërkohë, ankuesi vazhdimisht dhe fuqimisht argumentoi gjatë gjithë procedimeve të brendshme se ai ishte rrahur brutalisht. Megjithëse autoritetet u vunë në dijeni të rrahjes së ankuesit, prokurori nuk urdhëroi ekzaminimin mjekësor, nuk kërkoi prova të tjera, nuk hapi hetim penal ose, në të vërtetë nuk ndërmori asnjë hap për të hetuar pretendimet serioze dhe të përsëritura të ankuesit. Gjithashtu gjyqtari nuk kërkoi në seancën fillestare hetimin e shqetësimit të qartë fizik të ankuesit. Prandaj, ishte e arsyeshme për ankuesin të vlerësonte se, përveç mbrojtjes së tij ndaj akuzave penale, mjetet e tjera ligjore të brendshme ishin jo efektive (shih *Göçmen kundër Turqi*, nr. 72000/01, § 49, 17 Tetor 2006; *Veznedaroğlu kundër Turqisë*, nr. 32357/96, § 34, 11 Prill 2000; dhe, *Aksoy kundër Turqisë*, 18 Dhjetor 1996, §§ 54-57, *Raportet e Vendimeve dhe Gjykimeve* 1996-VI). Mbi këtë bazë, duhet të rrëzohet kundërshtimi paraprak i Qeverisë bazuar në mos-shterimin e mjeteve të brendshme ligjore. Meqenëse pretendimet e ankuesit ishin ngritur si pjesë e mbrojtjes së tij në të gjitha fazat e procedimit penal, paraqitja e kësaj ankese brenda gjashtë muajve të përfundimit të këtyre procedimeve penale (vendimi i Gjykatës Kushtetuese datë 6 Shkurt 2007) ishte brenda afateve të përfshira në Nenin 35 § 1.

93. Gjykata më tej pranon se rrahja e ankuesit ishte e një shkalle të tillë që ai duhej të mbahej për në sallën e gjyqit nga oficerët e policisë. Konkluzione mund të nxirren në masën që një trajtim i tillë i cili kishte lënë gjurmë të dukshme në ankuesin, siç u provua në seancën e datës 20 Prill 2000, është ushtruar qëllimisht nga oficerët e policisë gjatë marrjes së tij në pyetje. Rrahja e shkaktuar ndaj ankuesit mund të lindte tek ai ndjenjën e frikës dhe të ankthit që mund ta poshtëronte dhe përulte atë si dhe thyente qëndrueshmërinë e tij fizike ose morale me qëllim që ta detyronin të pranonte fajin.

94. Në fakt, sekuenca e ngjarjeve dëshmon se ankuesi i është nënshtruar sjelljes së dënueshme të oficerëve të policisë, me shumë gjasa për një periudhë të konsiderueshme kohe si pasojë e së cilës ai bëri deklarata ku inkriminonte veten dhe ankuesin e dytë me shpresën se do t'i jepte fund dhimbjes së rëndë fizike dhe mendore të shkaktuar ndaj tij. Trajtimi për të cilin ankohej ishte i një shkalle të tillë që përbënte torturë në kuptim të Nenit 3 të Konventës.

95. Për rrjedhojë, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të Nenit 3 të Konventës si për sa i përket anës thelbësore ashtu edhe procedurale.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 5 §§ 1 DHE 3 E KONVENTËS

96. Të dy ankuesit u ankuan se paraburgimi i tyre nuk bazohej në dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së veprës penale, në shkelje të Nenit 5 § 1 të Konventës. Ankuesi i dytë u ankua gjithashtu për kohëzgjatjen e paraburgimit të tij sipas Nenit 5 § 3 të Konventës. Neni 5, në masën që lidhet me çështjen, parashikon si më poshtë.

> "1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: ...
>
> (c) Arrestimi i ligjshëm ose ndalimi i një personi zbatuar me qëllimin e dërgimit të tij para autoritetit ligjor kompetent me dyshimin e arsyeshëm se ka kryer një shkelje ose kur vlerësohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen nga ana e tij të një shkeljeje ose arratisjen pas kryerjes së shkeljes; ...
>
> 3. Çdo person që arrestohet ose burgoset në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 (c) të këtij Neni, duhet të sillet menjëherë para një gjyqtari apo oficeri tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksionin gjyqësor dhe i njihet e drejta të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet me garancitë për t'u paraqitur për"

97. Ankuesi i parë kundërshtoi vlefshmërinë e arrestimit të tij para gjykatave të brendshme dhe vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 14 Korrik 2000 ishte vendimi përfundimtar në këtë drejtim. Meqenëse ankuesi i parë depozitoi ankimin e tij sipas Nenit 5 § 1 në këtë Gjykatë më 13 Korrik 2007, ky ankim është paraqitur jashtë afatit gjashtë-mujor dhe duhet të rrëzohet në përputhje me Nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës. Ankuesi i dytë u arrestua më 18 Prill 2000. Arrestimi i tij u konfirmua sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 20 Prill 2000 dhe ai nuk apeloi kundër këtij vendimi. Për rrjedhojë Gjykata rrëzon ankimin e tij sipas Nenit 5 § 1 të Konventës për mos-shterim të mjeteve të brendshme në përputhje me Nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

98. Për sa i përket ankimit të ankuesit të dytë sipas Nenit 5 § 3 për kohëzgjatjen e paraburgimit të tij, Gjykata thekson se paraburgimi përfundon për qëllimet e Konventës me shpalljen e fajësisë dhe caktimin e dënimit në shkallë të parë (*Caka kundër Shqipërisë*, nr. 44023/02, § 68, 8 Dhjetor 2009). Megjithëse paraburgimi i ankuesit të dytë përfundoi më 2 Dhjetor 2004 kur Gjykata e Apelit dha vendimin e saj duke e dënuar atë, ai nuk paraqiti këtë ankim deri më Korrik 2007. Rezulton se ky ankim duhet të rrëzohet si i parashkruar jashtë afatit në përputhje me Nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

99. Ankuesi i parë u ankua sipas Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) se i është mohuar e drejta e avokatit mbrojtës gjatë dy javëve të para të paraburgimit të tij përfshirë periudhën gjatë paraburgimit kur ai bëri deklaratat inkriminuese.

100. Sipas Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri (d) të Konventës, ankuesi i dytë u ankua se procedimet kishin qenë të parregullta në masën që lidheshin me pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave dhe në masën që atij nuk i ishte dhënë koha e mjaftueshme dhe lehtësitë për të përgatitur mbrojtjen e tij, për të pasur përfaqësim ligjor dhe për të pyetur dëshmitarët. Ai më tej pretendoi se trupi gjykues i Gjykatës së Lartë i datës 16 Shtator 2005 dhe 10 Dhjetor 2003 nuk ka shfaqur paanshmëri dhe se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 6 Shkurt 2007 nuk është arsyetuar siç duhet.

101. Sipas Nenit 6 § 1 të Konventës të dy ankuesit argumentuan se trupi gjykues i Gjykatës së Apelit i datës 2 Dhjetor 2004 nuk përbënte "një gjykatë të krijuar me ligj" dhe se kohëzgjatja e procedimeve ishte e tepërt.

102. Sipas Nenit 6 § 2 ato u ankuan se e drejta e tyre për t'u prezumuar të pafajshëm ishte shkelur si pasojë e fushatës së medias të bërë kundër ankuesit të dytë.

Pjesët përkatëse të Nenit 6 të Konventës parashikojnë si më poshtë.

" Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht... nga një gjykatë... e pavarur ... e cila do të vendosë...

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale presupozohet i pafajshëm deri kur vërtetohet fajtor sipas ligjit.

3. Çdo person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

(a) të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai kupton dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

(b) të ketë kohën e mjaftueshme dhe lehtësirat për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

(c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas nga një avokat i caktuar kryesisht kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

(d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

..."

A. Ankimi i ankuesit për shkeljen e Nenit 6 §§ 1 dhe 3 të Konventës

1. Pranueshmëria

108. Qeveria nuk ka ngritur asnjë bazë të papranueshmërisë në lidhje me këtë ankim.

103. Gjykata vlerëson se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar në kuptim të Nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Ajo më tej konstaton se nuk është i papranueshëm për asnjë arsye tjetër. Për rrjedhojë, ky ankim duhet të deklarohet i pranueshëm.

2. Meritat

(a) parashtrimet e palëve

104. Ankuesi i parë parashtroi se ishte keqtrajtuar dhe detyruar për të bërë deklarata vetë-inkriminuese. Familja e tij kishte caktuar një avokat mbrojtës menjëherë pas arrestimit të tij por ai nuk ishte lejuar të konsultohej me të për dy javë me rezultatin se avokati mbrojtës nuk ishte i pranishëm kur ai bëri këto deklarata, dhe as nuk ishte i pranishëm gjatë paraqitjes së tij fillestare në gjyq më 20 Prill 2000

105. Ankuesi i dytë kundërshtoi përdorimin e deklaratës së ankuesit të parë që inkriminonte atë, meqenëse ishte marrë nga keqtrajtimi në kundërshtim me Nenin 3 të Konventës.

106. Qeveria e kundërshtoi pretendimin e ankuesit të parë duke argumentuar se ai e kishte nënshkruar pranimin e fajit me vullnetin e tij të lirë. Sipas Kodit të Procedurës Penale hetuesit kishin të drejtë të mblidhnin prova në mungesë të avokatit mbrojtës të të akuzuarit. Ankuesi i parë ose familja e tij mund të kishin caktuar një avokat të zgjedhur prej tij ose prej tyre në çdo fazë të procedimit, dhe ata nuk ishin penguar për të vepruar në këtë mënyrë.

107. Për sa i përket ankuesit të dytë, Qeveria parashtroi se deklarata e ankuesit të parë ishin vërtetuar nga prova të tjera dhe nuk kishte shërbyer për të dënuar ankuesin e dytë.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

(i) Parime të përgjithshme

108. Gjykata rithekson se, si rregull aksesi për avokatin mbrojtës duhet të sigurohet që në radhën e parë të marrjes në pyetje të një të dyshuari nga policia, përveç nëse dëshmohet në dritën e rrethanave të veçanta të çdo çështjeje, se ekzistojnë arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë. Të drejtat e mbrojtjes, në parim do të cenohen në mënyrë të pandreqshme kur përdoren për dënim deklaratat inkriminuese të bëra gjatë marrjes në pyetje nga policia pa aksesin për avokat mbrojtës. (*Salduz kundër Turqisë* [GC], nr. 36391/02, § 55, 27 Nëntor 2008).

109. Nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e faktit ose të së drejtës të kryera nga një gjykatë e brendshme përveç se në masën kur ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa. Ndërsa Neni 6 garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor, ai nuk përcakton asnjë rregull mbi pranueshmërinë e provave si te tilla, gjë që kryesisht është çështje rregullimi sipas të drejtës së brendshme (shih *Jalloh kundër Gjermanisë* [GC], nr. 54810/00, § 94, ECHR 2006‑IX; *Schenk kundër Zvicrës*, 12 Korrik 1988, §§ 45-46, Seria A nr. 140; dhe *Teixeira de Castro kundër Portugalisë*, 9 Qershor 1998, § 34, *Raportet* 1998-IV).

110. Gjithashtu nuk është roli i Gjykatës për të përcaktuar, si parim i përgjithshëm, nëse lloje të veçanta provash – për shembull, të dhënat e marra në mënyrë të paligjshme në aspektin e të drejtës së brendshme – mund të jenë të pranueshme ose, në të vërtetë, nëse ankuesi ishte fajtor ose jo. Pyetja që kërkon përgjigje është nëse ishte e drejtë procedura në tërësi, duke përfshirë mënyrën në të cilën janë marrë provat. Kjo përfshin shqyrtimin e paligjshmërisë në fjalë dhe, kur ka të bëjë me shkeljen e një të drejte tjetër të Konventës, llojin e shkeljes së konstatuar (shih *Jalloh*, cituar më lart, § 95; *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35394/97, § 34, ECHR 2000-V; *P.G. dhe J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44787/98, § 76, ECHR 2001-IX; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 48539/99, § 42, ECHR 2002-IX).

111. Vlerësime të veçanta zbatohen në lidhje me përdorimin në procedimet penale të provave të marra në shkelje të Nenit 3. Kështu, pranimi i deklaratave të marra si rezultat i torturës ose keqtrajtimit tjetër në shkelje të Nenit 3 si dëshmi për të vendosur faktet përkatëse në procedimet penale e bën procedimin në tërësi të padrejtë, pavarësisht nga vlera provuese e deklaratave, dhe pavarësisht nëse përdorimi i tyre është vendimtar për të siguruar dënimin e të pandehurit (shih *Gäfgen kundër Gjermanisë* [GC], nr. 22978/05, §§ 165-166, ECHR 2010).

(ii) Zbatimi i parimeve përkatëse në çështjen e ankuesit të parë

112. Gjykata ka konstatuar në çështjen në fjalë se deklaratat e ankuesit të parë të cilat inkriminonin si atë vetë ashtu edhe ankuesin e dytë ishin marrë si rezultat i torturës. Ajo vëren se gjykatat e brendshme i pranuan këto deklarata në prova. Në dritën e parimit të përcaktuar në *Gäfgen*, cituar më lart, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës për këtë arsye.

113. Për më tepër, deklaratat inkriminuese të ankuesit përcaktonin se ai kishte vendosur të fliste në mungesë të avokatit mbrojtës. Gjykata vëren se Qeveria nuk iu përgjigj pretendimit

të ankuesit se atij i është refuzuar aksesi për avokatin e tij mbrojtës dhe nuk argumentoi se atij i është kujtuar e drejta e tij për të mos folur në mungesë të avokatit mbrojtës dhe për pasojat që rridhnin nga deklarata të bëra pa u konsultuar me një avokat mbrojtës. Gjykata më tej vlerëson se duke pasur parasysh torturën së cilës i është nënshtruar ankuesi i parë, si rezultat i së cilës ai mund të ketë dashur t'i japë fund vuajtjeve të tij, nuk mund të thuhet se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij e aksesit për avokat mbrojtës në mënyrë të prerë, pa presion.

114. Nëse, siç pretendon Qeveria, ankuesi kishte nivel të ulët arsimimi (shih paragrafin 86 më lart), ky fakt duhet të kishte kërkuar kujdes të mëtejshëm nga ana e autoriteteve (shih *Płonka kundër Polonisë*, nr. 20310/02, § 38, 31 Mars 2009). Gjykata vëren se Qeveria nuk ka kërkuar, e aq më pak dëshmuar, se ekzistonte një arsye bindëse për të kufizuar aksesin e ankuesit të parë për avokat mbrojtës para dhënies së deklaratave të tij (shih paragrafin 112 më lart). Deklarat e paditura janë përdorur në gjyq dhe në fakt kanë shërbyer si baza e vetme për dënimin e ankuesit (shih paragrafët 37 dhe 46 më lart). As ndihma e dhënë më vonë nga avokatët mbrojtës dhe as natyra kundërshtuese e procedimeve në vijim nuk mund të ndreqnin këtë defekt (shih *Salduz*, cituar më lart, § 58).

115. Për rrjedhojë ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me Nenin 6 § 3 (c) për sa i përket ankuesit të parë.

(iii) Zbatimi i parimeve në çështjen e ankuesit të dytë

116. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se ankuesi i dytë është dënuar, *inter alia*, mbi bazën e deklaratave inkriminuese të bëra nga ankuesi i parë. Këto deklarata ishin marrë si pasojë e shkeljes së Nenit 3. Në rastin konkret Gjykata për rrjedhojë duhet të vendosë peshën që duhet t'i jepet deklaratave inkriminuese të një pale të tretë të cilat janë marrë si rezultat i torturës dhe të cilat janë përdorur më pas në gjyq për dënimin e të akuzuarit.

117. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të shqyrtojë tendencat në praktikat e saj ligjore në lidhje me përdorimin e deklaratave inkriminuese të marra në shkelje të Nenit 3.

(α) Në lidhje me përdorimin në gjyq të deklaratave vetë-inkriminuese të të vetëakuzuarit të marra në shkelje të Nenit 3

118. Gjykata ka përcaktuar se deklaratat vetë-inkriminuese të ankuesit të marra në shkelje të Nenit 3, pavarësisht nga klasifikimi i keqtrajtimit, dhe të cilat janë përdorur në gjyqin e tij, pavarësisht nga vlera e tyre provuese, e bënë gjykimin në tërësi të padrejtë (shih, për shembull, *Levinţa kundër Moldavisë*, nr. 17332/03, 16 Dhjetor 2008; *Stanimirović kundër Serbisë*, nr. 26088/06, 18 Tetor 2011; *Iordan Petrov kundër Bullgarisë*, nr. 22926/04, 24 Janar 2012; *Grigoryev kundër Ukrainës*, nr. 51671/07, 15 Maj 2012; *Hajnal kundër Serbisë*, nr. 36937/06, 19 Qershor 2012).

119. I vetimi përjashtim i praktikës së mësipërme ligjore është vendimi në rastin e *Alchagin kundër Rusisë* (nr. 20212/05, 17 Janar 2012), nëpërmjet të cilit deklarata e pranimit të fajit që ishte marrë si pasojë e trajtimit çnjerëzor dhe degradues në kundërshtim me Nenin 3, nuk çonte në shkelje automatike të gjykimit të përgjithshëm të ankuesit, për shkak të faktit se deklarata e pohimit të fajit ishte bërë fillimisht në prani të një avokati mbrojtës, se ishte mbrojtur në gjykim dhe se të drejtat e ankuesit për mbrojtje ishin garantuar në gjykim.

(β) Në lidhje me përdorimin në gjykimin e të akuzuarit të deklaratave inkriminuese të një pale të tretë të marra si rezultat i torturës në shkelje të Nenit 3

120. Gjykata rithekson se në çështjen e *Harutyunyan kundër Armenisë* (nr. 36549/03, ECHR 2007-III) ajo konstatoi, *inter alia*, se përdorimi i deklaratave të dëshmitarëve që ishin

marrë nga tortura, siç përcaktohej nga gjykatat e brendshme, dhe të cilat ishin përdorur në gjykimin e ankuesit për të siguruar dënimin e tij, e bënin gjykimin në tërësi të padrejtë.

121. Në çështjen e *Othman (Abu Qatada) kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 8139/09, 17 Janar 2012), në lidhje me mohimin e pretenduar flagrant të drejtësisë për sa i përket ankuesit që përballet me deportim në Jordani për të dalë në Gjyq, Gjykata vendosi se pranimi i deklaratave të bashkë-pandehurit, të cilat ishin marrë nga tortura dhe inkriminonin ankuesin, përbënin shkelje të Nenit 6 të Konventës në rastin e deportimit të ankuesit dhe gjykimit në Jordani.

122. Për rrjedhojë Gjykata konkludon se pranimi në prova i deklaratave inkriminuese të marra nga një palë e tretë si rezultat i torturës e bën procedimin në tërësi të padrejtë, pavarësisht nëse prova të tilla ishin vendimtare për të siguruar dënimin e ankuesit. Prova të tilla nuk duhet të marrin petkun e ligjshmërisë dhe të përdoren në gjyq për dënimin e të akuzuarit meqenëse mund të dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme drejtësinë e gjykimit (shih, *mutatis mutandis*, *Gäfgen*, cituar më lart § 167; dhe, *Salduz*, cituar më lart, § 55).

(γ) Konkluzion

123. Për arsyet e mësipërme, Gjykata çmon se gjykimi i ankuesit të dytë në tërësi ishte i padrejtë për shkak të pranimit dhe përdorimit të deklaratave inkriminuese të ankuesit të parë të marra nga tortura.

124. Për rrjedhojë ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e dytë.

B. Në lidhje me pjesën e mbetur të ankimeve të ankuesit sipas Nenit 6 § 1 të Konventës

1. Mungesa e pretenduar e paanshmërisë së Gjykatës së Lartë

125. Ankuesi i dytë u ankua për mungesë paanshmërie të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë më 10 Dhjetor 2003 dhe 16 Shtator 2005.

126. Qeveria parashtroi se ankuesi i dytë nuk kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore.

127. Gjykata vëren se ankuesi i dytë nuk arriti të ngrejë këtë ankesë para Gjykatës Kushtetuese, e cila është kompetente për të shqyrtuar gjitha çështjet e drejtësisë sipas Nenit 6. Rrjedhimisht, Gjykata çmon se ky ankim duhet të pushohet për mos-shterim të mjeteve të brendshme ligjore dhe të rrëzohet sipas Nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

2. Mungesa e pretenduar e arsyeve në vendimin e Gjykatës Kushtetuese

128. Ankuesi i dytë u ankua se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 7 Shkurt 2007 nuk është arsyetuar siç duhet.

129. Gjykata vëren se kur Gjykata Kushtetuese nuk pranon apelin kushtetues me argumentin se nuk është plotësuar baza ligjore për çështjen, kërkesat e Nenit 6 të Konventës mund të plotësohen nga një arsyetim shumë i kufizuar (shih, ndër të tjera, *Jakupi kundër Shqipërisë* (dec.), nr. 11186/03, 1 Dhjetor 2009). Për më tepër, Gjykata thekson konstatimet e saj në paragrafin 129 më lart lidhur me padrejtësinë e pretenduar të procedimeve.

130. Për arsyet e mësipërme, Gjykata çmon se ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet sipas Nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

3. Ankimi se Gjykata e Apelit e datës 2 Dhjetor 2004 nuk ishte "gjykatë e krijuar me ligj"

131. Ankuesit parashtruan se përbërja e Gjykatës së Apelit e datës 2 Dhjetor 2004 ishte e paligjshme, pasi gjyqtarët ishin gjyqtarë ushtarakë. Ankuesit gjykuan se procedura e ndjekur ishte në shkelje të së drejtës dhe kontestuan vendimin e marrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Sipas tyre, Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet t'i kishte transferuar gjyqtarët nga gjykata të tjera të zakonshme të apelit në vend që t'i transferonte nga gjykata ushtarake e apelit.

132. Qeveria parashtroi se tre gjyqtarët e Gjykatës Ushtarake të Apelit ishin transferuar për të dëgjuar çështjen pasi të gjithë gjashtëmbëdhjetë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiraë, në një fazë të caktuar të procedimeve, ishin përfshirë në dëgjimin e ankimeve të paraqitura nga ankuesit. Transferimi ishte bërë për të garantuar paanshmërinë e trupit gjykues dhe ishte në përputhje me të drejtën e brendshme.

133. Sipas Nenit 6 § 1 të Konventës, një "gjykatë" gjithmonë duhet "të krijohet me ligj". Kjo frazë pasqyron parimin e shtetit ligjor që është i natyrshëm në të gjithë sistemin e Konventës dhe Protokollet e tij. Fraza "i krijuar me ligj" pasqyron jo vetëm legjislacionin lidhur me krijimin dhe juridiksionin e një gjykate (shih *Lavents kundër Latvia*, nr. 58442/00, § 114, 28 Nëntor 2002), por gjithashtu edhe përbërjen e trupit gjykues në çdo rast (shih *Buscarini kundër San Marino* (dec.), nr. 31657/96, 4 Maj 2000, dhe *Posokhov kundër Rusisë*, nr. 63486/00, § 39, ECHR 2003 IV). Një "gjykatë" sipas Nenit 6 § 1 të Konventës duhet të plotësojë gjithashtu një sërë kushtesh të tjera që përfshijnë pavarësinë e anëtarëve të saj dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre, paanshmërinë dhe ekzistencën e garancive procedurale (shih *Cowme dhe Të tjerë kundër Belgjikës*, nr. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 dhe 33210/96, § 99, ECHR 2000-VII).

134. Gjykata vëren se sipas dispozitave të Ligjit të Sistemit Gjyqësor ka qenë dhe mbetet i mundur transferimi i gjyqtarëve në trupin gjykues të gjykatave të tjera përveç gjykatave të tyre. Dispozita të caktuara ligjore duhet të përmbushen për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit dhe për të parandaluar në çdo mënyrë manipulimin e trupit gjykues si dhe për të garantuar gjykim të drejtë. Për shembull, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka autoritetin të vendosë mbi transferimet. Për më tepër, dispozitat e zbatueshme të Ligjit të Sistemit Gjyqësor kufizojnë periudhën për të cilën një detyrë e tillë mund të bëhet për tre muaj në vit.

135. Në rastin konkret, Gjykata vëren se më 23 Shtator 2004 Kryetari i Gjykatës së Apelit i kërkoi Këshillit të Lartë të Drejtësisë të emëronte tre gjyqtarë për të dëgjuar çështjen e ankuesve, meqenëse të gjithë gjyqtarët e kësaj gjykate ishin përfshirë më parë në gjykimin e çështjes së ankuesve. Në përgjigje të kësaj, më 25 Tetor 2004 Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendosi t'i transferonte tre gjyqtarët nga Gjykata Ushtarake e Apelit për të gjykuar ankuesit. Vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë u bazua në nenin 28 të Ligjit të Sistemit Gjyqësor.

136. Gjykata e çmon të ligjshme arsyen e transferimit të gjyqtarëve, pikërisht për të siguruar paanshmërinë dhe pavarësinë e trupit gjykues. Nuk është detyrë e Gjykatës të shqyrtojë nëse autoritetet duhet t'i kishin transferuar gjyqtarët nga gjykata të tjera të zakonshme të apelit, çështje që mbetet në diskrecionin e Qeverisë së paditur, por të verifikojë nëse mënyra në të cilën është kryer transferimi dhe garancitë që e rrethojnë janë në përputhje me Nenin 6 (shih, *mutatis mutandis*, *Incal kundër Turqisë*, 9 Qershor 1998, § 70, *Raportet* 1998-IV).

137. Ankuesit nuk kanë kundërshtuar faktin se gjyqtarët e gjykatës ushtarake gëzojnë të gjitha garancitë ligjore të pavarësisë të njëjta me ato të gjyqtarëve civilë. Për shembull, ato kryejnë të njëjtin trajnim arsimor dhe profesional që u jep atyre statusin e anëtarëve të

karrierës së gjyqësorit. Ata emërohen nga KLD dhe janë të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre. Mandati i tyre nuk kufizohet në kohë dhe nuk mund të largohen nga detyra apo të dalin në pension para kohe nëse nuk plotësohen kushtet e kërkuara me ligj. Ata mbeten subjekt i të njëjtit proces disiplinor dhe vlerësimi të zbatueshëm për gjyqtarët civilë (shih paragrafin 76 më lart). Në rastin konkret, Gjykata vëren se ankuesit nuk kanë arritur të paraqesin asnjë element që sjell mungesën e pavarësisë së gjyqtarëve të gjykatës ushtarake.

138. Për sa i përket kushtit të "paanshmërisë", ankuesit nuk treguan asnjë rrethanë që të dëshmonte mungesën e paanshmërisë objektive apo subjektive (shih *Driza kundër Shqipërisë*, nr. 33771/02, §§ 75–76, ECHR 2007-V (ekstrakte)) nga ana e gjyqtarëve të gjykatës ushtarake të cilët dëgjuan çështjen dhe dënuan ankuesit. Gjithashtu nuk është përdorur Kodi Penal Ushtarak. Së fundi, as para Gjykatës dhe as para gjykatave të brendshme, nuk është argumentuar e aq më pak parashtruar se gjyqtarët e gjykatës ushtarake kanë punuar përtej afatit statutor tre-mujor.

139. Rrjedhimisht, Gjykata nuk dallon asnjë shkelje të legjislacionit të brendshëm. Gjykata e Apelit e datës 2 Dhjetor 2004 ishte për rrjedhojë "gjykatë e krijuar me ligj" në kuptim të Nenit 6 § 1 të Konventës. Nga kjo rrjedh se ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me Nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

4. Kohëzgjatja e pretenduar e procedimeve

(a) Pranueshmëria

140. Qeveria nuk ngriti asnjë argument të pranueshmërisë në lidhje me ankimin.

141. Gjykata çmon se ky ankim është haptazi i pabazuar në kuptim të Nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo më tej konstaton se ankimi nuk është i papranueshëm për ndonjë arsye tjetër. Rrjedhimisht duhet të deklarohet i pranueshëm.

(b) Meritat

142. Ankuesit argumentuan se procedimet penale kishin zgjatur për një periudhë të paarsyeshme kohore. Çështjet kundër tyre nuk ishin komplekse. Vonesat konsistonin në rikthime të çështjes nga gjykatat më të larta në gjykatat më të ulëta. Autoritetet nuk arritën të marrin masa të cilat do të kishin shmangur rikthime të tilla dhe do të kishin garantuar një përfundim të shpejtë të procedimeve.

143. Qeveria parashtroi se faktet e çështjes ishin komplekse duke pasur parasysh veprat penale që ishin kryer dhe numrin e veprimeve hetuese që duhej të kryheshin. Rrjedhimisht, kjo kërkonte zgjatjen e afateve për kryerjen e hetimit penal. Për sa i përket procedimeve të gjykimit, Qeveria deklaroi se ishin marrë në pyetje një numër i konsiderueshëm i dëshmitarëve. Ajo më tej ia atribuoi ankuesve kohëzgjatjen e procedimeve, të cilët kishin apeluar kundër çdo veprimi të një gjykate më të ulët ndaj një gjykate më të lartë. Sipas mendimit të saj, procedimet ishin kryer brenda një afati kohor të arsyeshëm.

144. Gjykata vëren se procedimet filluan më 18 Prill 2000 kur u arrestuan ankuesit, dhe përfunduan më 6 Shkurt 2007 me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Kështu periudha që duhet të konsiderohet është afërsisht 6 vjet dhe 11 muaj.

145. Gjykata përsërit se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve në vijim: kompleksiteti i çështjes, sjellja e ankuesit dhe autoriteteve përkatëse si dhe çfarë ishte në rrezik për ankuesin në fjalë (shih *Sürmeli kundër Gjermanisë* [GC], nr. 75529/01, § 140, ECHR 2006-VII).

146. Gjykata pranon se çështja kundër ankuesve lidhet me vrasjen që përfshinte një shkallë të caktuar kompleksiteti, duke përfshirë sigurimin e provave nga jashtë.

147. Gjykata nuk konstaton se ankuesit ishin përgjegjës për kohëzgjatjen e procedimeve, veçanërisht duke pasur parasysh rezultatin e suksesshëm të apelimeve të tyre.

148. Problemi kryesor në çështjen në fjalë, të cilën Gjykata e ka shqyrtuar në një rast të mëparshëm kundër Shtetit të paditur përbëhej nga rikthime të shumta të çështjes nga gjykatat më të lartë në gjykatat më të ulëta (shih *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, §§ 141-146, ECHR 2007-XIV (ekstrakte)). Gjykata vëren, në veçanti, se pasi çështja ishte dëgjuar nga Gjykata e Lartë më 15 Janar 2003 ajo u dërgua në Gjykatën e Rrethit për rishqyrtim. Në procedimet e reja, Gjykata nuk veproi në përputhje me udhëzimet e Gjykatës së Lartë dhe se ky mosveprim rezultoi në një seri tjetër procedimesh, të cilat zgjatën dy vjet deri në miratimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 15 Tetor 2004, i cili la në fuqi dënimet e ankuesve. Gjykata vlerëson se kjo vonesë i atribuohej tërësisht gjykatave të brendshme.

149. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.

C. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të prezumimit të pafajësisë

150. Të dy ankuesit u ankuan se fushata mediatike kundër tyre shkeli të drejtën e tyre që të konsiderohen të pafajshëm.

151. Gjykata vëren se ekziston njohje e përgjithshme e faktit se gjykatat nuk mund të funksionojnë në boshllëk. Ndërkohë që gjykatat janë forumi për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së personit për një vepër penale, kjo nuk do të thotë se nuk mund të ketë asnjë diskutim paraprak ose të njëkohshëm të objektit të gjykimeve penale diku tjetër, qoftë ky në gazeta të specializuara, në shtypin e përgjithshëm në mesin e publikut të gjerë (shih *Craxi kundër Italisë*, nr. 34896/97, § 99, 5 Dhjetor 2012; dhe, *Pullicino kundër Maltës* (dhjetor), nr. 45441/99, 15 Qershor 2000). Jo vetëm që mediat e kanë për detyrë dhënien e informacioneve dhe ideve në lidhje me çështjet që dalin para gjykatave, ashtu si në fusha të tjera të interesit publik; publiku gjithashtu ka të drejtë t'i marrë ato (shih, ndërmjet të tjerash, The Sunday Times *kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1)*, 26 Prill 1979, § 65, Seria A nr. 30; dhe *Worm kundër Austrisë*, 29 Gusht 1997, § 50, *Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve* 1997-V). Me kusht që media të mos kapërcejë kufijtë e caktuar në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, raportimi, duke përfshirë komentet, mbi procedimet e Gjykatës kontribuon në publicitetin e tyre dhe kështu është tërësisht në pajtim me kërkesat sipas Nenit 6 § 1 të Konventës që seancat të jenë publike (shih *Pullicino*, cituar më lart). Rrjedhimisht Neni 6 § 2 nuk mund të pengojë autoritetet që të informojnë publikun për hetimet penale në vazhdimësi, por kërkon që ato të veprojnë kështu me të gjithë diskrecionin dhe maturinë e nevojshme nëse duhet të respektohet prezumimi i pafajësisë (shih, ndër të tjera, *Peša kundër Kroacisë*, nr. 40523/08, § 139, 8 Prill 2010).

152. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se artikujt e shtypit nuk përmbanin asnjë deklaratë nga zyrtarët publik që cënonte prezumimin e pafajësisë së ankuesve. Ata thjesht paraqitën një transmetim kronologjik të gjykimit dhe apelimit të ankuesve, më së shumti të ndjekur nga citime dhe intervista, kryesisht me avokatin mbrojtës të ankuesit të dytë. Ankuesit nuk janë shprehur se një fushatë mediatike ishte zhvilluar kundër tyre me rrezikshmëri të tillë sa të ndikonte ose kishte të ngjarë të ndikonte në rezultatin e procedimeve. Ata nuk kanë paraqitur asnjë provë konkrete të tillë, duke përfshirë dëshmi se autoritetet në ndonjë mënyrë i kishin zbuluar informacionet shtypit, ose kishin nxitur

raportime paragjykuese në media (shih *Beggs kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dhjetor), nr. 15499/10, 16 Tetor 2012).

153. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me Nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

V. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 7 TË KONVENTËS

154. Ankuesi i dytë u ankua se ka pasur shkelje të Nenit 7 § 1 të Konventës në faktin se gjykatat e brendshme e kishin dënuar atë në mënyrë prapavepruese mbi bazën e Nenit 78 § 2 të KP-së, që ishte paraqitur pas kryerjes së veprave të pretenduara.

Neni 7 i Konventës parashikon si më poshtë:

> "1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.
>
> 2. Ky Nen nuk cenon gjykimin dhe dënimin e çdo personi për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer ishte penal sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohur nga vendet e civilizuara."

155. Qeveria parashtroi se ankuesi i dytë nuk e ngriti këtë ankim as para Gjykatës së Lartë dhe as para Gjykatës Kushtetuese.

156. Gjykata konstaton se ankuesi i dytë në të vërtetë nuk arriti të ngrejë këtë ankim para Gjykatës Kushtetuese. Edhe nëse Gjykata Kushtetuese nuk duhej të konsiderohej si mjet ligjor i brendshëm për qëllimin e Nenit 7 të Konventës, vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 Shtator 2005 është dhënë më shumë se gjashtë muaj nga data e paraqitjes së këtij ankimi para Gjykatës më 13 Korrik 2007.

157. Nga kjo rrjedh se ky ankim duhet të deklarohet i papranueshëm dhe të rrëzohet në përputhje me Nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

VI. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

158. Neni 41 i Konventës parashikon:

> "Kur Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës apo të Protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi

159. Ankuesit e lanë në diskrecionin e Gjykatës përcaktimin e shumës së dëmit jo-material të cilën ata kishin të drejtë duke pasur parasysh praktikën e saj ligjore në raste të ngjashme.

160. Qeveria deklaroi se konstatimi i shkeljes përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për ankuesit në çdo rast, ata nuk kishin vërtetuar pretendimet e tyre për dëmet. Nëse Gjykata vendosi njw shpërblim, Qeveria kërkoi që shpërblimi i drejtë duhet të marrë parasysh faktet e çështjes, kompleksitetin e saj dhe sjelljen e ankuesve.

161. Gjykata thekson se, në lidhje me ankuesin e parë, ajo konstatoi shkelje reale dhe procedurale të Nenit 3 të Konventës dhe shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (c) të Konventës. Gjykata gjithashtu konstatoi shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e dytë për shkak të pranimit në prova të deklaratave inkriminuese të ankuesit të parë të marra nga tortura. Ajo më tej konstatoi shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës lidhur me të

drejtën e të dy ankuesve për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Në rrethanat e çështjes në fjalë Gjykata shpërblen ankuesin e parë me 15,600 euro në lidhje me dëmin jo - material dhe vlerëson se konstatimi i shkeljeve përbën shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me ankuesin e dytë.

162. Megjithatë, për sa i përket kompensimit për shkelje të Nenit 6 të Konventës në lidhje me të dy ankuesit, Gjykata përsërit se forma më e përshtatshme e kompensimit do të ishte vendosja e të dy ankuesve sa më shumë që të jetë e mundur në pozitën në të cilën ata do të kishin qenë nëse do të respektohej kjo dispozitë. Forma më e përshtatshme e kompensimit, në parim, do të ishte gjykimi *de novo* ose rihapja e procedimeve nëse kërkohet (shih *Caka kundër Shqipërisë*, nr. 44023/02, § 122, 8 Dhjetor 2009; *Laska dhe Lika kundër shqipërisë*, nr. 12315/04 dhe 17605/04, §§ 74-76, 20 Prill 2010; *Berhani kundër Shqipërisë*, nr. 847/05, § 91, 27 Maj 2010; dhe, *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 77-79, 10 Maj 2011).

B. Kostot dhe Shpenzimet

163. Ankuesit parashtruan se nuk kishin asnjë faturë për të paraqitur në Gjykatë. Sipas një marrëveshjeje verbale që ata kishin me avokatin e tyre dhënia e kostove dhe shpenzimeve kushtëzohej nga rezultati i çështjes para Gjykatës.

164. Qeveria kundërshtoi pretendimet e ankuesve për kostot dhe shpenzimet meqenëse ato nuk ishin të provuara. Ajo i kërkoi Gjykatës pushimin e tyre.

165. Sipas praktikës ligjore të Gjykatës, ankuesi ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm në masën që është provuar se ato janë shkaktuar në të vërtetë dhe domosdoshmërisht dhe ishin të arsyeshme në masë. Në çështjen në fjalë, duke marrë parasysh mungesën e faturave dhe dokumenteve mbështetëse, nuk është bërë asnjë akordim sipas këtij kreu.

C. Interesi i mospagimit

166. Gjykata çmon të nevojshme se interesi i mospagimit duhet të bazohet në nivelin marxhinal të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, të cilit duhet t'i shtohen 3 për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT

1. *Vendos* të bashkojë ankimet;

2. *Bashkon* meritat e kundërshtimeve paraprake të Qeverisë në lidhje me ankimin e ankuesit të parë sipas Nenit 3 të Konventës;

3. *Deklaron* ankimet e ankuesit të parë sipas Nenit 3 dhe Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (c) të Konventës të pranueshme; ankimin e ankuesit të dytë sipas Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me padrejtësinë e procedimeve si dhe ankimin e të dy ankuesve në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve dhe pjesën e mbetur të ankimeve të dy ankuesve të papranueshme;

4. *Vendos* se ka pasur shkelje të Nenit 3 të Konventës sipas pjesëve të saj reale dhe procedurale në lidhje me ankuesin e parë dhe rrjedhimisht *rrëzon* kundërshtimet paraprake të Qeverisë;

5. *Vendos* se ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e parë për sa i përket pranimit dhe përdorimit të deklaratave të marra në shkelje të Nenit 3;

6. *Vendos* se ka pasur shkelje të Nenit 6 § 3 (c) në lidhje me ankuesin e parë lidhur me mohimin e aksesit për avokat mbrojtës gjatë mbikëqyrjes policore;

7. *Vendos* se ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e dytë për sa i përket pranimit dhe përdorimit të deklaratave të marra nga ankuesi i parë në shkelje të Nenit 3;

8. *Vendos* se ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me të drejtën e të dy ankuesve për gjykim brenda një periudhe të arsyeshme;

9. *Vendos*

(a) qe Shteti i paditur t'i paguajë ankuesit të parë, brenda tre muajve nga data e daljes së vendimit përfundimtar, në përputhje me Nenin 44 § 2 të Konventës, 15,600 euro (pesëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind euro) për dëme jo-materiale, plus çdo taksë që mund të vihet, të konvertuara në monedhën e brendshme në kursin e këmbimit në datën e pagesës;

(b) që prej skadimit të periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në pagim, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marxhinal të huasë të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 për qind;

10. *Vendos* se konstatimi i shkeljeve përbën një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me ankuesin e dytë;

11. *Rrëzon* pjesën tjetër të mbetur të pretendimit të ankuesit për shpërblim të drejtë.

Bërë në Anglisht, dhe njoftuar me shkrim më 25 Qershor 2013, në përputhje me Nenin 77 § 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Françoise Elens-Passos
Sekretar

David Thór Björgvinsson
Kryetar

Në përputhje me Nenin 45 § 2 të Konventës dhe Neni 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, bashkangjitur këtij vendimi, opinioni më vete i Gjyqtarit Bianku.

D.T.B.
F.E.P.

OPINION UNANIM I GJYQTARIT BIANKU

Pajtohem me konkluzionet e Dhomës se ka pasur shkelje të Nenit 3, si në aspektin real ashtu edhe procedural, për sa i përket ankuesit të parë dhe shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket ankuesit të parë dhe të dytë (pikat 4, 5 dhe 7 të dispozitave vepruese të vendimit). Megjithatë, më vjen keq, unë nuk jam në gjendje të bie dakord me arsyetimin e kolegëve të mi të ditur mbi dy çështjet e lidhura në këtë rast.

A. A është përdorur torturë ndaj ankuesit të parë?

Ankuesi i parë, Z. Kaçiu, u arrestua më 18 Prill 2000. Ai pretendoi se një ditë më vonë, më 19 Prill 2000, ai është marrë në pyetje nga një prokuror dhe ka dhënë shpjegime që inkriminojnë ankuesin e dytë për shkak të dhunës së përdorur ndaj tij nga oficerët e policisë në të njëjtën ditë. Më 20 Prill 2000, ai pretendohet se është shoqëruar nga oficerët e policisë në sallën e gjyqit. Pretendimi se ndaj tij është përdorur forcë është konfirmuar nga procesverbali i seancës të së njëjtës datë (paragrafët 11-14 të vendimit). Është për të ardhur keq, për të thënë më të paktën, nuk duket se këto pretendime janë shqyrtuar nga autoritetet Shqiptare pavarësisht nga kërkesa e avokatit mbrojtës të ankuesit të parë të caktuar nga Gjykata. Duke pasur parasysh këto elemente, nuk ka dyshim se ka pasur shkelje procedurale të Nenit 3 të Konventës në lidhje me ankuesin e parë dhe pajtohem me konkluzionet e Dhomës në këtë drejtim.

A ka pasur gjithashtu shkelje reale të Nenit 3? Qeveria nuk reagoi ndaj pretendimeve të ankuesit dhe avokatit të tij mbrojtës për përdorimin e forcës nga oficerët e policisë më 19 Prill 2000, dhe as nuk dha asnjë shpjegim të çfarëdo lloji për shenjat në trupin e ankuesit të parë dhe gjendjen e tij shëndetësore në sallën e gjyqit më 20 Prill 2000.

Në përcaktimin nëse një formë e veçantë trajtimi arrin kufirin e përgjithshëm të Nenit 3, Gjykata ka miratuar standardin e provës "përtej dyshimit të arsyeshëm" duke shtuar se "një provë e tillë mund të vijojë nga bashkekzistenca e konkluzioneve mjaft të forta, të qarta, dhe pajtuese ose të prezumimeve të pakundërshtueshme të ngjashme të faktit" (shih *Ireland kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 18 Janar 1978, § 167, Seria A nr. 25). Që prej këtij vendimi, Gjykata ka konfirmuar në mënyrë të përsëritur se "me qëllim që keqtrajtimi të bjerë në objektin e Nenit 3, ai duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie. Vlerësimi i këtij minimumi varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore dhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës". Gjykata ka shtuar se "faktorë të mëtejshëm" përfshijnë qëllimin për të cilin është shkaktuar trajtimi së bashku me qëllimin apo motivimin pas tij..., si dhe kontekstin e tij, të tillë si atmosfera e emocioneve dhe tensioneve të shtuara" (shih *Gäfgen kundër Gjermanisë* [GC], nr. 22978/05, § 88, ECHR 2010). Të gjitha këto parime së bashku me elementin e qëllimshëm që karakterizon torturën, janë theksuar qartë në paragrafët 87-93 të vendimit të Dhomës në çështjen në fjalë.

Sipas mendimit tim, problemi qëndron në mënyrën se si Dhoma aplikoi këto parime të përgjithshme në çështjen në fjalë. Para së gjithash, vendimi pranon "mungesën e çdo lloj përshkrimi të dëmtimeve të pësuara" nga ankuesi i parë (paragrafi 95 i vendimit). Më tej në të njëjtin paragraf, sugjerohet që pretendimet e ankuesit të parë "krijuan prezumimin e faktit se ankuesi i ishte nënshtruar keqtrajtimit ndaluar sipas Nenit 3, në duart e agjentëve të Shtetit". Duke patur parasysh se këto pretendime nuk janë hetuar nga autoritetet, me të drejtë Dhoma konstaton shkelje të pjesës procedurale të Nenit 3. Fakti se nuk është paraqitur asnjë provë mjekësore apo prova të tjera çoi në konkluzionin se këto pretendime mbetën vetëm një prezumim i faktit. Rrjedhimisht, konstatohen në vendim shprehjet "mund të nxirren konkluzione" se trajtimi ishte i qëllimshëm (paragrafi 98 i vendimit), ose "me shumë gjasa"

për vlerësimin e kohëzgjatjes së keqtrajtimit, natyrës së tij dhe, madje edhe elementin e qëllimshëm. Nuk jam i bindur se kjo analizë është në përputhje me kërkesën e "provës përtej dyshimit të arsyeshëm". Në një situatë në të cilën ankuesi i parë nuk është ankuar në mënyrë specifike për torturë, dhe një gjë e tillë nuk përcaktohet në nivel të brendshëm ose nga ndonjë burim tjetër (paragrafi 91 i vendimit); për gjykatën tonë të hidhet dhe të konkludojë se ankuesi ishte torturuar krijon, sipas mendimit tim, një konkluzion jashtëzakonisht të gjerë dhe të pasigurtë. Standardi i provës, domethënë "përtej dyshimit të arsyeshëm" dhe konsideratat në lidhje me to të provave përcaktuar më lart, sipas mendimit tim, duhet të zbatohen me shumë kujdes kur është fjala për akuzat e torturës – forma më e rëndë e trajtimit ndaluar sipas Nenit 3 – dhe për rrjedhojë nuk mund të përcaktohet nga prezumimi, konkluzioni dhe as nga probaliteti (krahaso me *Selmouni kundër Francës* [GC], nr. 25803/94, §§ 91-106, ECHR 1999-V; *Gäfgen*, cituar më lart, § 94; *Dedovskiy dhe të tjerë v. Rusisë*, nr. 7178/03, §§ 39-50, 59-61 dhe 80-86, ECHR 2008 (ekstrakte); *Savitskyy kundër Ukrainës,* nr. 38773/05, §§ 15-18 dhe 129-139, 26 July 2012; *Virabyan kundër Armenisë*, nr. 40094/05, §§ 17-29 dhe 31, 2 Tetor 2012; dhe, *Lenev kundër Bullgarisë*, nr. 41452/07, §§ 111-18, 4 Dhjetor 2012).

Unë gjithashtu pyes veten nëse gjykimi në këtë rast përçon mesazh të gabuar, domethënë se pretendimet e thjeshta nga ankuesit për keqtrajtim në masën që nuk janë hetuar në nivel të brendshëm – automatikisht çojnë në shkeljen reale të Nenit 3 për shkak të torturës?! Leximi im i praktikës ligjore të kësaj Gjykatë është se, në raste të tilla mos sigurimi nga ana e autoriteteve të shpjegimeve bindëse për dëmtime të shkaktuara nga një person nën kontrollin e tyre çon në konkluzionin se ka pasur gjithashtu shkelje reale të Nenit 3 (shih, ndër të tjera, *Tomasi kundër Francës*, 27 Gusht 1992, §§ 108-11, Seria A nr. 241-A; *Ribitsch kundër Austrisë*, 4 Dhjetor 1995, § 34, Seria A nr. 336; dhe, *Selmouni*, cituar më lart, § 87). Megjithatë, me qëllim që të provohet nëse është përdorur torturë, duhet të plotësohen gjithashtu kërkesat dhe standardet e tjera të provave të shpjeguara më lart. Nga pikëpamja e praktikës sonë ligjore të gjykatës dhe rrethanave faktike të kësaj çështjeje, unë nuk jam në gjendje të arrij në përfundimin se ankuesi është torturuar, megjithëse jam plotësisht dakord se pa pasur shkelje reale të Nenit 3 të Konventës[1] .

B. A ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e parë dhe të dytë për shkak të përdorimit të veprimeve në kundërshtim me Nenin 3 ndaj ankuesit të parë?

Sipas pikës sime të parë, se tortura nuk është përcaktuar në rastin e ankuesit të parë por një shkelje e pacaktuar e pjesës reale të Nenit 3, kthehem tani në pikën e dytë: Nëse ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me ankuesin e parë dhe të dytë për shkak të përdorimit të forcës, që nuk cilësohet si torturë ndaj ankuesit të parë.

Çështja e përdorimit të provave të marra në rrethana në kundërshtim me Nenin 3 ka qenë objekt i disa vendimeve të kësaj Gjykate. Duke cituar *Gäfgen* (cituar më lart, §§ 165-66), vendimi i Dhomës përsërit se "konsiderata të veçanta zbatohen në lidhje me përdorimin në procedimet penale të provave të marra në shkelje të Nenit 3. Prandaj, pranimi i deklaratave të marra si pasojë e torturës ose keqtrajtimit në shkelje të Nenit 3 si provë për të përcaktuar faktet përkatëse në procedimet penale i bën procedimet si një e padrejtë e tërë, pavarësisht nga vlera vërtetuese e deklaratave dhe pavarësisht nëse përdorimi i tyre është vendimtar në sigurimin e dënimit të të pandehurit" (paragrafi 117 i vendimit).

1. Gjykata ka konstatuar vazhdimisht shkelje të përgjithshme të pjesëve thelbësore të Nenit 3 në disa raste pa specifikuar formën e keqtrajtimit të pësuar (shih, ndër të tjera, *Taraburca kundër Moldovisë*, nr. 18919/10, §§ 48-53, 6 Dhjetor 2011; dhe *Yusuf Gezer kundër Turqisë*, nr. 21790/04, §§ 31-33, 1 Dhjetor 2009).

Por a duhet të cilësohet trajtimi si torturë para se një shkeljeje e Nenit 3 gjithashtu të mund të çojë në shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës? Dy vendimet e Dhomës së Madhe ose kanë lënë të hapur çështjen nëse përdorimi i provave reale të marra nga një veprim të klasifikuar si trajtim çnjerëzor dhe degradues por që nuk përbën torturë, e bën gjithmonë gjykimin të padrejtë (*Jalloh kundër Gjermanisë* [GC], nr. 54810/00, §§ 106-07, ECHR 2006-IX), ose kanë shmangur përgjigjen direkte të pyetjes në terma të përgjithshme, për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes dhe mungesës së një lidhjeje shkakësore ndërmjet metodave të ndaluara të hetimit dhe dënimit të ankuesit (*Gäfgen*, cituar më lart, § 180). Ashtu si në opinionin e përbashkët kundërshtues në gjykimin e *Gāfgen* nga disa Gjyqtarë në përbërje të kësaj Dhome të Madhe, unë do të përsëris se "Gjykata mund t'i ishte përgjigjur kësaj pyetje duke pohuar kategorikisht, në mënyrë të qartë, se pavarësisht nga sjellja e të akuzuarit, drejtësia, për qëllimin e Nenit 6, presupozon respektin e shtetit ligjor dhe kërkon, si një propozim vetë-evident, përjashtimin e çdo prove që është marrë në shkelje të Nenit 3. Një gjykim penal që pranon dhe bazohet, në çdo masë, në prova të marra si pasojë e shkeljes së një dispozite të tillë absolute të Konventës nuk mund të jetë *a fortiori* i drejtë. Shpreh keqardhjen për ngurrimin e Gjykatës për të kaluar këtë kufi përfundimtar dhe për të krijuar një rregull të qartë ose "të përcaktuar qartë" në këtë zonë kryesore të të drejtave themelore të njeriut[2]."

Sipas mendimit tim, pavarësisht nga cilësimi i trajtimit të ndaluar duke konstatuar shkelje reale të Nenit 3 të Konventës, një shkelje e Nenit 6 § 1 të Konventës duhet të ishte konstatuar në këtë rast përsa i përket ankuesit të parë dhe të dytë. Kjo edhe më shumë sepse, ndryshe nga rasti *Gäfgen* (cituar më lart, §§ 32 dhe 147), nuk janë bërë deklarata të mëvonshme nga ankuesi i parë që të konfirmonte në Gjykatë deklarata inkriminuese të bëra më parë nga ai gjatë kujdestarisë. Në të kundërt, ankuesi i parë këmbënguli se këto deklarata janë marrë prej tij si pasojë e përdorimit të forcës (paragrafët 28, 31, 33 dhe 49 i vendimit aktual). Kjo është e gjitha aq më tepër në një situatë ku pretendimet e ankuesit të parë se i është nënshtruar trajtimit në kundërshtim me Nenin 3 të Konventës, ndeshën në heshtjen totale dhe pasivitetin e autoriteteve shqiptare, pavarësisht nga detyrimet e tyre procedurale sipas Nenit 3 dhe dijenisë së tyre mbi pretendimet e përfshira në periudhën e procedimeve penale ndaj dy ankuesve. Sipas mendimit tim, veçanërisht në një rast të tillë kur ankuesi i parë bëri deklarata që inkriminonin ankuesin e dytë, ne duhet të kishim pyetur veten nëse, duke lënë mënjanë çështjen e torturës, mund të jetë e mjaftueshme një formë më e lehtë keqtrajtimi ndaluar nga Neni 3 kundër ankuesit të parë për të marrë këto deklarata për të konkluduar se drejtësia e gjykimit të ankuesit të dytë ishte rrezikuar për shkak të këtij përdorimi. Sipas mendimit tim, Dhoma duhet të kishte zgjedhur për një zbatim më të gjerë të objektit të rregullit përjashtues në lidhje me provat e marra si pasojë e shkeljes së Nenit 3. Kjo gjithashtu do të kishte çuar në sqarimin e praktikës sonë ligjore mbi këtë çështje[3] dhe do të kishte forcuar qëndrueshmërinë e zbatimit të saj.

[2]. Shih paragrafin 2 të Opinionit të Përbashkët Pjesërisht Kundërshtues të Gjyqtërëve Rozakis, Tulkens, Jebens, Ziemele, Bianku dhe Power në vendimin e *Gäfgen*. Shih gjithashtu paragrafin 3.2 të Opinionit Kundërshtues të Gjyqtarit Cabral Barreto në vendimin e Dhomës së Madhe në çështjen *Bykov kundër Rusisë* [GC], nr. 4378/02, 10 Mars 2009).

3. Për vendimin që pranon rregullin përjashtues në rastet kur shkelja e Nenit 3 nuk është cilësuar si torturë, shih *Hulki Güneş kundër Turqisë*, nr. 28490/95, ECHR 2003-VII (ekstrakte); *Söylemez kundër Turqisë*, nr. 46661/99, 21 Shtator 2006; dhe, *Göçmen kundër Turqisë*, nr. 72000/01, 17 Tetor 2006.

Zgjedhja e shumicës e parë nga perspektiva e fakteve të çështjes në fjalë, nxjerr në pah një problem tjetër. Siç është theksuar tashmë në opinionin pjesërisht kundërshtues përmendur më lart në vendimin e *Gāfgen* do të ishte e vështirë për një Gjykatë që ka pranuar se mungesa e një avokati mbrojtës në fazat fillestare të një hetimi e bën tërë gjykimin të padrejtë (*Salduz kundër Turqisë* [GC], nr. 36391/02, 27 Nëntor 2008), të kufizojë objektin e rregullit përjashtues vetëm për provat e marra nga tortura. Ose, e thënë ndryshe, të mos kishte kurajon për të zgjeruar objektin e rregullit përjashtues në mënyrë që të pasqyronte të gjitha provat e marra në shkelje të Nenit 3. Faktet e çështjes në fjalë i ofruan Gjykatës avantazhin, ose në të vërtetë disavantazhin që të kishte si elementin *Salduz* ashtu edhe *Gäfgen*. Ndërsa Dhoma në paragrafin 120 të vendimit pranon se mungesa e avokatit mbrojtës në fazat fillestare të procedimeve kundër ankuesit të parë e nxori tërë gjykimin të padrejtë, sipas parimit të Salduz, duket se kërkon veprime të paditura që të cilësohen si torturë me qëllim që të konkludojë se ka pasur shkelje të garancisë për gjykim të drejtë. A do të thotë kjo se parimi Salduz është më bindës se parimi Jalloh ose Gäfgen? Një gjë e tillë do të jetë e vështirë, nëse jo e pamundur, për t'u mbrojtur duke pasur parasysh natyrën e Neneve në lojë, Nenin 6 që nga njëra anë garanton të drejta jo-absolute dhe, nga ana tjetër Nenin 3 dhe karakterin absolut të tij.

Për arsyet e mësipërme, unë besoj se Dhoma duhet të ketë konstatuar shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës pa pasur nevojë për të arritur, si një çështje paraprake, në përfundimin se ankuesi i parë i ishte nënshtruar torturës, të cilin unë e vlerësoj si konkluzion të pasigurtë mbi faktet e çështjes. Fakti që ankuesi i parë është keqtrajtuar në kundërshtim me Nenin 3, do të kish qenë i mjaftueshëm në vetvete për të bazuar një shkelje të Nenit 6 në lidhje me të dy ankuesit. Kjo zgjidhje nuk do të ndryshonte asgjë për ankuesit, por do të kishte çuar në një rezultat i cili do të kishte qenë më i qartë dhe më në përputhje me praktikën tonë ligjore sipas Neneve 3 dhe 6.